

1 E martë, 29 mars 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuarit hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.33 paradite

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita.

7 Z. Sekretar, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar  
9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i  
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit, z. Sekretar.

13 Së pari të paraqiten të pranishmit.

14 Për ZPS-në në fillim, kush janë të pranishëm?

15 Keni fjalën.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Për Prokurorinë  
17 sot paraqiten, Cezary Michalczuk, Prokuror; Julie Mann,  
18 Menaxhere e Lëndës; Hristina Petrova, stazhiere; dhe unë,  
19 Filippo Di Minicis, Ndihmësprokuror.

20 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofon.

21 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Jemi ekipi i Mbrojtjes së  
22 Viktimave. Sot paraqiten Annie Pues, Mbrojtëse e Viktimave dhe  
23 unë, Ann Brechtje Vossenber, bashkëmbrojtëse.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

2 Mbrojtja përfaqësohet nga Betim Shala, bashkëmbrojtës;  
3 nga, unë vetë, Julius Von Bone; nga përkthyesi dhe hetuesi  
4 Fatmir Pelaj. Dhe i pranishëm në sallë është dhe z. Mustafa.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
6 Faleminderit.

7 Për procesverbalin, ky proces zhvillohet para Trupit  
8 Gjykues numër I.

9 Sot do të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes  
10 Jakup Ismaili, me numër 400. Por përpara kësaj, dëshiroj që të  
11 lëshoj një urdhër gojarisht lidhur me dokumentet -- një  
12 dokument të nxjerrë sot në mëngjes.

13 Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja sot në mëngjes ka nxjerrë  
14 një material tjetër shtesë për t'u përdorur në kundrapyetjet  
15 që do t'ia bëjë dëshmitarit numër 400, duke bërë të ditur se  
16 materiali 105394-ET gjithashtu do të përdoret në kundrapyetjet  
17 që do t'i bëhen këtij dëshmitari.

18 Trupi Gjykues vëren se ky material ka të bëjë me një  
19 listë emrash të veteranëve të UÇK-së.

20 Së pari, duam të kuptojmë është nga burim publik?

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Kështu është.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Faleminderit.

24 Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja i ka kërkuar leje Trupit  
25 Gjykues që ta përdorë materialin e nxjerrë lidhur me

1 kundrapyetjet që do t'ia bëjë dëshmitarit numër 400. Këtë  
2 material e ka nxjerrë më datë 29 mars, përmes emailit dërguar  
3 në orën 9.01. Trupi Gjykues mendon se ZPS-ja ka bërë këtë  
4 kërkesë në përputhje me paragrafin 34 [sipas përkthimit] të  
5 vendimit për zhvillimin e procesit që është parashtrim i  
6 protokolluar me numër 170 dhe bën të ditur se ky material nuk  
7 është nxjerrë përpara.

8 Trupi Gjykues mendon se ZPS-ja ka treguar arsye të  
9 vlefshme dhe se ky material është burimi i hapur.

10 Për rrjedhojë Trupi Gjykues e autorizon ZPS-në ta përdorë  
11 këtë material në kundrapyetjet që do ja bëjë Dëshmitarit me  
12 numër 400.

13 Këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht.

14 Tani do të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit numër 400.

15 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërohëni dëshmitarin  
16 të hyjë në sallë.

17 [Dëshmitari hynë në sallën e gjyqit]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Mirëmëngjes z. Ismaili. Mirë se erdhët në Dhomat e  
20 Specializuara. Më dëgjoni?

21 DËSHMITARI: Po, ju dëgjoj. Mirëmëngjesi.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pikë  
23 së pari, si jeni?

24 DËSHMITARI: Mirë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit, z. Ismaili. Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj.

2 Z. Ismaili, ju kanë thirrur të dëshmoni përpara Dhomave  
3 të Specializuara në çështjen gjyqësore Prokuroria i  
4 Specializuar kundër Salih Mustafës për të ndihmuar Trupin  
5 Gjykues që të marrë një vendim. Pasi të bëni deklaratën  
6 solemne për të thënë të vërtetën, do t'ju bëjë pyetje Avokati  
7 i Mbrojtjes së z. Mustafa, që është ulur në të djathtën tuaj;  
8 avokatët që përfaqësojnë viktimat e pranuar të marrin pjesë  
9 në këtë gjyqësore, që janë ulur pranë jush, në të majtën tuaj;  
10 dhe përfaqësuesit e Prokurorisë, që janë ulur pranë tyre; në  
11 fund fare, do ju bëjmë edhe ne, anëtarët e Trupit Gjykues.

12 Dëshiroj t'ju jap disa udhëzime sesi t'u përgjigjeni  
13 pyetjeve që do t'ju bëhen.

14 Z. Ismaili, ju lutem dëgjoheni me kujdes secilën pyetje.  
15 Nëse nuk e kuptoni, lirisht mund të kërkonit që pyetja t'ju  
16 përsëritet. Duam që të thoni të vërtetën, të na tregoni se  
17 çfarë keni parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni dëgjuar dhe  
18 ndjerë ju vetë. Nëse nuk e keni parë apo dëgjuar ju vetë por e  
19 keni marrë vesh në një mënyrë tjetër, na e thoni këtë. Mund të  
20 mos t'u kujtohen të gjitha detajet e ngjarjeve dhe kjo nuk  
21 përbën problem. Mjafton të dëshmoni për atë që ju kujtohet.

22 Gjithashtu ju rikujtoj se mund të kundërshtoni, pra, të  
23 mos pranoni të jepni dëshmi për gjëra të cilat mund t'ju  
24 fajësojnë në përputhje me rregullin 151, paragrafi 1, të  
25 Rregullores.

1 I kuptuat të gjitha këto?

2 DËSHMITARI: Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Dëshiroj t'ju jap tani disa këshilla praktike për dëshminë.

5 Gjithçka që themi këtu përkthehet dhe regjistrohet, pra,  
6 është e rëndësishme që të flisni ngadalë, të flisni qartë dhe  
7 të flisni pranë mikrofonit. Në këtë mënyrë që përkthyesit mund  
8 të përkthejnë gjithçka. Duhet të filloni të flisni vetëm pasi  
9 të ketë përfunduarës foluri personi që po jua bën pyetjen.  
10 Sepse, nëse ka mbivendosje, përkthyesit nuk mund ta  
11 përkthejnë. Kur t'ju bëhet një pyetje, prisni pesë sekonda,  
12 pastaj jepni përgjigjen. Këto pesë sekonda janë të rëndësishme  
13 për të gjithë ne që të dëgjojmë siç duhet, të përkthejmë dhe  
14 të regjistrojmë atë që thoni ju.

15 Po të keni pyetje, nëse keni nevojë për pushim, mjafton  
16 të ngrini dorën dhe do t'ua jap unë fjalën.

17 I kuptuat të gjitha këto z. Ismaili?

18 DËSHMITARI: Po.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
20 mirë. Siç veprojmë me çdo dëshmitar, tani do t'ju kërkoj të  
21 lexoni deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Ju  
22 rikujtoj se përbën veprë penale në juridiksionin e Dhomave të  
23 Specializuara dhënia e dëshmisë së rreme.

24 E kuptuat këtë?

25 DËSHMITARI: Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
2 mirë.

3 Znj. Asistente e sallës, ju lutem ndihmoheni dëshmitarin  
4 me deklaratën solemne.

5 Z. Ismaili, lexoni tekstin që ua dhanë.

6 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime  
7 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të  
8 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe  
9 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

10 DËSHMITARI: JAKUP ISMAILI

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Faleminderit, z. Ismaili. Tani jeni dhe në betim për të thënë  
13 të vërtetën.

14 Mund të fillojmë me dëshminë e z. Ismaili duke filluar me  
15 Avokatin e Mbrojtjes dhe pyetjet që do t'i bëjë ai.

16 Z. Avokat, keni vlerësuar se ju nevojiten dy orë për  
17 pyetjet që do ja bëni këtij dëshmitari. Si zakonisht, ju lutem  
18 informoheni Trupin Gjykes nëse do të keni ndryshime në  
19 planifikim.

20 Keni fjalën.

21 Pyetje nga z. Von Bone:

22 Py. Mirëdita, z. Dëshmitar.

23 Pë. Mirëdita.

24 Py. Z. Dëshmitar, do t'ju bëj pyetje lidhur me situatën në  
25 vitin 1999, lidhur dhe me deklaratën që na e keni dhënë më

1 përpara.

2 Pë. Në rregull.

3 Py. Në vitin 1999, në mars të atij viti, a mund të na thoni  
4 ku jetonit?

5 Pë. Në mars të vitit 1999, jetoja në Prishtinë.

6 Py. A mund të na e përshkruani paksa situatën në Prishtinë  
7 aso kohe dhe me se merreshit ose çfarë po bënit ju  
8 ekzaktësisht në Prishtinë aso kohe?

9 Pë. Në vitin 1999, ne jena marrë me çështje të cilat kanë  
10 pasë të bëjnë me ndihma humanitare.

11 Py. Ju kuptoj. A ekzistonte nevoja në Prishtinë aso kohe për  
12 t'u marrë me ndihma humanitare?

13 Pë. Po.

14 Py. Në fakt, cila ishte arsyeja pse e ishte e nevojshme  
15 ndihma humanitare?

16 Pë. Arsyeja ishte se në Prishtinë kanë qenë të zhvendosur  
17 popullata, e cila është shpërngulë nga rajone të tjera të  
18 luftës, siç ka qenë rajoni i Drenicës, Dukagjinit dhe rajoneve  
19 tjera. Ka qenë domosdoshmëri për me formu një këshill të  
20 emergjencës për me ndihmu atë popullatë.

21 Py. Thoni që kjo popullatë erdhi në Prishtinë. Po ku  
22 strehoheshin këta njerëz?

23 Pë. Popullata strehohej nëpër familje të tona së pari, mandej  
24 dhe nëpër familje nëpër fshatra. Në përgjithësi në Prishtinë  
25 dhe rrethinat.

1 Py. Me se ishit aktivë, me se merreshit? Mund të shpjegoni  
2 diçka më shumë për këtë?

3 Pë. Ne, vija e furnizimit me ushqime dhe me gjëra të cilat  
4 kanë pasë nevojë popullata kena marrë dhe jena furnizu nga  
5 bamirësit, e kam fjalën, nga fshatrat të cilat kanë grumbullu  
6 miell, sidomos ka qenë Kamenica, e cila -- fshati Kamenicë të  
7 cilin -- jena furnizu më së shumti nga Kamenica. Jena furnizu  
8 nga shoqata e Nënë Terezës, nga shoqata të ndryshme, Kryqi Kuq  
9 e të tjerë.

10 Py. Çfarë ka qenë tamam-tamam Këshilli Komunal për  
11 Emergjencat?

12 Pë. Po, Këshilli Komunal i Emergjencave është themelu nga  
13 këshilli republikan. Domethënë Qeveria e Përkohshme që ka qenë  
14 në ekzil i ka mjetet dhe i ka financu, përveç ndihmave që i  
15 thashë pak ma herët edhe nga bamirësit tjerë. Kanë financu.  
16 Edhe atje janë ble të gjitha produktet të cilat kanë qenë të  
17 nevojshme barna, për shembull, janë ble në brenda Kosovës.  
18 Edhe aty kanë fillu tani me u shpërnda.

19 Py. Këshilli Komunal për Emergjenca ku ndodhej, domethënë  
20 kishte një vendndodhje të veçantë apo kishte më shumë sesa një  
21 vendndodhje?

22 Pë. Këshilli Komunal i Emergjencave ishte i vendosur në një  
23 shtëpi private në Velani.

24 Py. Aso kohe sa njerëz ishin aktivë pranë këtij Këshillit  
25 Komunal për Emergjencat? Domethënë sa njerëz ndihmonin, sa



1 njerëz bënë punë aktive për të?

2 Pë. Sa me kujtohet, atëherë ka qenë dikun afër 12-13 vetë. Po  
3 ka qenë aktive dhe këshillet e tjera të subjektit të LDK-së.  
4 Kanë qenë dhe ata aktivistë edhe ata kanë ardhë kanë marrë  
5 ndihma dhe kanë shpërndarë nëpër popullatë, përveç neve.

6 Py. Ju përmendët LDK-në. Çfarë është kjo?

7 Pë. Kjo është një subjekt politik që ka funksionu në atë  
8 kohë. Dhe funksionon edhe sot.

9 Py. Edhe ju keni qenë në këtë gjithashtu?

10 Pë. Edhe unë kam qenë në këtë subjekt politik, Lidhja  
11 Demokratike e Kosovës.

12 Py. Në ç'mënyrë aktivitetet e LDK-së kishin lidhje me  
13 Këshillin Komunal për Emergjencën? Domethënë, së pari, a  
14 kishte ndonjë lidhje, ndonjë raport, a përfshihej LDK-ja?  
15 Ishte e përfshirë LDK-ja në këtë këshill?

16 Pë. LDK-ja ishte e përfshirë në strukturat organizative të  
17 këshillit të emergjencës. Domethënë shumica e aktivistëve, të  
18 cilët kanë ekzistuar edhe ma herët, kanë qenë të përfshirë.  
19 Domethënë për me mujt me e përfshi terrenin e tërë Kosovën.

20 Py. Këshilli Komunal për Emergjencë me kë kishin kontakte?  
21 Mendoj, se nja dy i përmendët më përpara, por dua të mësoj  
22 diçka më shumë për këtë. Më duket se përmendët pak më përpara,  
23 shoqatën "Nënë Tereza", Kryqin e Kuq. Çfarë lloj kontaktesh  
24 kanë qenë këto?

25 Pë. Përveç Qeverisë së Përkohshme që e ka financuar, kanë qenë

1 të inkorporum në aktivitet edhe shoqata e "Nënë Terezës" edhe  
2 Kryqi i Kuq edhe organizata të tjera të cilat, për shembull,  
3 për atë kohë nuk kam ditë -- nuk e di çfarë organizata kanë  
4 qenë. Po ndihma kanë pru.

5 Py. Ju vetë kishit ndonjë funksion në këtë Këshill Komunal  
6 për Emergjencën?

7 Pë. Unë në këshill organizativ, si fillim, mandej kam qenë  
8 direkt aktiv në shpërndarjen e ndihmave të cilat kanë ardhë  
9 aty.

10 Py. Në ç'pjesë shpërndareshin këto?

11 Pë. Në të gjitha pjesët e Kosovës, por kryesisht ka qenë  
12 Prishtina për shkak se ka pasë zhvendosje të popullatës në  
13 Prishtinë dhe është dashtë me gjet rrugën si me furnizu me  
14 barna, me ushqim edhe me strehë.

15 Py. A ju kujtohet se kur kanë fillu sulmet ajrore të NATO-s  
16 në Kosovë?

17 Pë. Po.

18 Py. Kur kanë filluar?

19 Pë. Më 24 mars.

20 Py. Të vitit 1999, ma merr mendja?

21 Pë. Po. Në 1999. Po.

22 Py. Aktivitetet e Këshillit Komunal për Emergjencë,  
23 zhvilloheshin edhe përpara sulmeve ajrore të NATO-s?

24 Pë. Aktivitetet e këshillit të emergjencës edhe para sulmit  
25 të NATO-s kanë qenë në funksion dhe janë shpërnda ndihmat për

1 nevoja të popullatës edhe për nevoja të njerëzve të cilët kanë  
2 qenë të paralizuar, të sëmurë, të plagosur.

3 Py. Kur ka filluar ekzistencën e vet Këshilli Komunal për  
4 Emergjencën? Pak a shumë, përafërsisht.

5 Pë. S'e kuptova pyetjen. Dhe njëherë?

6 Pë. Pyetja që kam është Këshilli Komunal për Emergjencë, kur  
7 e ka filluar punën e vet? Flasim përpara sulmeve ajrore.

8 Pë. Sa më kujtohet mu, një vit përpara. Sa më kujtohet.

9 Py. Domethënë një vit përpara?

10 Pë. Para sulmeve të NATO-s.

11 Py. Në rregull. Sapo cekët 24 marsin, fillimin e sulmeve  
12 ajrore. Situata në Prishtinë a ndryshoi aso kohe, pra, në atë  
13 ose më saktë pas këtij momenti kohor?

14 Pë. Pas këtij momenti kohor, posa kanë fillu sulmet e NATO-s  
15 më 24 mars 1999, ka ndryshu dukshëm. Ne, forcat serbe, forcat  
16 serbe paramilitare, forcat ushtarake, ne na kojsiderojshin  
17 fajtorë për sulmet e NATO-s. Edhe duke na lënë fajtorë ata  
18 fillun me e rrit represionin ndaj popullatës me vrasje,  
19 dëbime, maltratime, pa kursy gra, fëmijë, pleq, të paralizum.  
20 Edhe u është rritë presioni. Dhe fajtori ishim ne për sulmet e  
21 NATO-s.

22 Py. Ju kuptoj. Çfarë lloj veprimesh këto forcat serbe,  
23 ushtria, policia --

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Avokat i Mbrojtjes, a mund të na tregoni se ç'drejtim keni

1 marrë me këto pyetje? Sepse do të doja -- domethënë nuk dua që  
2 t'ju ndërhyj në provat që paraqisni si Mbrojtje, por dua edhe  
3 të di sesi lidhet kjo me Aktakuzën. Përpara se të përgjigjeni  
4 do t'i kërkoj dëshmitarit --

5 Z. Dëshmitar do t'i bëj një pyetje.

6 Anglishten e flisni? A e kuptoni anglishten?

7 DËSHMITARI: Nga pak. Nga pak e kuptoj.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Atëherë do t'i kërkoj Asistentes së sallës që t'ju shoqëroj të  
10 dilni nga salla sepse preferoj që ky diskutim që do të bëjmë  
11 këtu të mos bëhet në praninë tuaj.

12 DËSHMITARI: Okei.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

17 Avokat, keni fjalën.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.

19 Aktivitetet e dëshmitarit janë një fill i kuq që lidhin të  
20 gjitha aktivitetet e kësaj periudhe për të cilën po flasim.

21 Prandaj dhe unë mendoj se do të ishte e dobishme fillimisht që  
22 të shikonim, të konstatojmë se cilat janë këto aktivitete,  
23 cili është organizimi e kështu me radhë, në mënyrë që të mos  
24 na duhen më pyetje të tjera për këto çështje.

25 Duke qenë se këto aktivitete sipas mendimit tim, përbëjnë

1 një fill të kuq të aktivitete të tij gjatë periudhës mars-  
2 prill 1999, mendova që ishte e dobishme dhe një mënyrë e  
3 natyrshme për të filluar me dëshmitarin për këtë.

4 Në fakt, ky ishte drejtimi që u kisha dhënë pyetjeve.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por,  
6 ajo çfarë neve dëgjua deri tani, kishte të bënte me  
7 deklarimin e asaj çfarë bëhej nga serbët në atë pjesë të  
8 Kosovës, këta na tha dëshmitari deri tani. Unë nuk dua që të  
9 kemi pyetje shumë për këtë çështje, sepse kjo është diçka të  
10 cilën ne e dimë, e kemi lexuar dhe në libra, kështu që  
11 dëshmitari duhet të japi një dëshmi konkrete lidhur me gjërat  
12 që di vetë ai dhe çfarë ka parë dhe që lidhet me çështjen  
13 tuaj, me mbrojtjen tuaj dhe që lidhet gjithashtu edhe me  
14 Aktakuzën.

15 Edhe dje patëm një marrje në pyetje që ishte goxha e  
16 gjerë. Kështu që do t'ju bëja thirrje që të jeni më konkret në  
17 pyetjet që bëni. Do t'ju kërkoja që të jeni më specifik lidhur  
18 me llojet e përgjigjeve që doni të merrni nga dëshmitari sepse  
19 nuk do t'ju lejoj që të vazhdoni me këtë mënyrë duke marrë  
20 informacion që nuk është i rëndësishëm për arsyet tona. Nuk do  
21 ta shpenzojmë kohën kështu, megjithëse ky informacion është  
22 shumë interesant, nuk është qëllimi apo fusha e interesit tonë  
23 që të merremi me një informacion kaq të gjerë.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

1 Sekretare, ju lutem shoqëroheni përsëri në sallë dëshmitarin.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
4 se u kthyet përsëri z. Dëshmitar. Tani do të vazhdojmë me  
5 marrjen tuaj në pyetje nga Avokati i Mbrojtjes.

6 Avokat, e keni ju fjalën tani.

7 Z. VON BONE: [Përkthim]

8 Py. Do ta përfundoj këtë pjesë.

9 Z. Dëshmitar, sapo na e bëtë pak të qartë atë çfarë po  
10 ndodhte në Prishtinë dhe çfarë po bënin forcat serbe atje. A  
11 shkaktoi kjo ndonjë dallim kjo në shpërndarjen materialeve që  
12 juve ju duhet që të shpërndanit në popullatë? Njerëzit që  
13 ishin në Prishtinë, domethënë, aktiviteti, veprimtaria juaj u  
14 përqendrua vetëm në Prishtinë apo shkoi përtej kësaj?

15 Pë. Po ca forcat ushtarake, policore, paramilitare, bënë një  
16 -- kanë bërë një dëbimin e popullatës edhe për shkak të  
17 represionit edhe dhunës popullata u detyru të shpërngulet nga  
18 Kosova. Domethënë të merr kahjen për t'u shpërngul për në  
19 Maqedoni edhe për pjesë të fshatrave të Prishtinës, rrapinës  
20 së Prishtinës.

21 Dhe gjithë aktiviteti i këshillit të emergjencës ra  
22 poshtë. Domethënë nuk ka qenë e pamundshme me funksionu. Edhe  
23 u detyrum, popullata bashkë me ne, gradualisht të bëjna plane  
24 për me u shpërngul nga Prishtina. Ne aktivistat u shpërngulëm  
25 në një pjesë të fshatrave, popullatat u shpërngulën në

1 Maqedoni dhe në pjesë të fshatrave të ndryshme. Edhe ashtu u  
2 bë dëbimi. Dëbimi u bë me dhunë.

3 Py. Ti vetë a u largove nga Prishtina për të shkuar për diku  
4 tjetër?

5 Pë. Po.

6 Py. Kur ka ndodhur kjo? Kur je larguar nga Prishtina?

7 Pë. Unë së bashku me shokun tim Sabit Krasniqin, tash i  
8 ndjerë, kena vazhdu rrugën për në Hajvali për m'u tërhjek në  
9 Mramor edhe me pa se ku mujna me e gjet një organizim të ri  
10 për me fillu me ndihma humanitare. Se kena ndëgju që vërshu,  
11 një numër shumë i madh në atë pjesë, popullata.

12 Py. Pra, ka ndodhur në datën kur filluan sulmet ajrore,  
13 atëherë jeni larguar?

14 Pë. Ashtu mes datës 24 --

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Avokat, ju lutem, a mund ta bëni pyetjen -- a mund të bëni një  
17 pyetje të hapur të mos e orientoni dëshmitarin për përgjigje.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]

19 Py. Pyetja ime ishte kjo: Në çfarë date, me pikë reference 24  
20 marsin kur ndodhën sulmet ajrore, pra, cila ishte data në të  
21 cilën ti u largove nga Prishtina? Kur u largove nga Prishtina?

22 Pë. Unë u largova mbas orës 12.00, të 24 marsit, domethënë  
23 24-25 mars.

24 Py. Në rregull. E kuptoj. Ku shkuat fillimisht?

25 Pë. Ne vazhduam rrugën për në fshatin Hajvali për me pa si --

1 e kemi pa të arsyeshme të shkojmë në fshat, të hijmë në fshat  
2 për shkak se ka qenë e pamundshme me u tërhjek nga ajo pjesë.  
3 Py. Në rregull. Me kë ishit kur shkuat në Hajvali?

4 Pë. Me Sabit Krasniqin, shokun tim, tash i ndjerë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Avokat, mendoj që e bëtë njëherë këtë pyetje se thatë që shkoi  
7 në këtë fshat, pastaj shkoi në Mramor dhe që shkoi me Sabit  
8 Krasniqin. Këtë e kemi në procesverbal, në rreshtat e  
9 mëparshëm.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Po dua që të kalojmë dhe  
11 njëherë gjithë këtë lëvizje me dëshmitarin.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.  
13 Po them që këtë informacion, në fakt, e morëm dhe më përpara.

14 Z. VON BONE: [Përkthim]

15 Py. Nga Hajvalia ose ta bëj ndryshe. A qëndruat në Hajvali  
16 dhe në qoftë se po, për sa kohë qëndruat atje?

17 Pë. Nuk më kujtohet saktë, po më kujtohet që kena qëndru  
18 derisa kena bë një plan për me u tërhjek, për shkak se nga  
19 gjuajtjet e NATO-s, si duket aty ka qenë një bazë ushtarake  
20 dhe ka ekzistuar municion ushtarak edhe ka pasë shpërthime. Edhe  
21 nga shpërthimet e materieve, të cilat nuk i di, ka pasë të  
22 lënduar shumë njerëz, ka pasur dhe policë serbë edhe ushtarë  
23 serbë edhe ka pasë popullatë shumë të vrarë, ku s'kena mujtë  
24 me identifikuar saktë se ç'ka janë. Janë shqiptarë, a janë  
25 serbë, a ç'ka janë. Veç kena pa të lënduar dhe të vrarë shumë



1 aty në atë pjesën e Hajvalisë. Ne kemi dalë nga aty edhe  
2 forcat paramilitare nuk e kanë vërejtë që mundet me ekzistuar që  
3 mundet me pasë ndonjë shqiptar edhe kena dalë ashtu me një  
4 rrezikshmëri të lartë. Jena tërhjek ashtu me një rrezikshmëri  
5 mjaft të lartë.

6 Py. Kur thua "kena dalë" me këtë ishiti?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Avokat a e morët përgjigjen për pyetjet që bëtë, domethënë,  
9 për sa kohë qëndroi ai atje?

10 Pë. Avokati nuk mendoj.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po

12 mendoj që kjo është pyetje e juaj, kështu që nuk është detyra  
13 ime që të verifikoj në qoftë se i merrni përgjigjet për  
14 pyetjet tuaja. Dhe ne pamë që kemi marrë një përgjigje  
15 tërësisht tjetër. Kështu që, në qoftë se nuk e merrni  
16 përgjigjen ndaloheni dëshmitarin, bëjani edhe njëherë pyetjen  
17 dhe merrni përgjigjen e pyetjes.

18 Ju lutem, vazhdoni.

19 Z. VON BONE: [Përkthim]

20 Py. Pra, ti the që nuk ishe vetëm: Pyetja ime ishte kjo: kur  
21 shkuat në Hajvali, për sa kohë qëndruat atje? Për këtë pyetje  
22 specifike po ju kërkoj të përgjigjeni.

23 Pë. Përafërsisht, sa më kujtohet, se është kohë e gjatë,  
24 vetëm dikun 24 orë. Ashtu më duket që kena ndejtë, kenë  
25 qëndru.

1 Py. E kuptojmë. Po nga aty ku shkuat? Ku shkuat më pas?

2 Pë. Vazhduam rrugën në drejtim të Mramorit.

3 Py. Kur thua "vazhduam" e kuptoj që ishe bashkë me këtë  
4 shokun që sapo the, me Sabit Krasniqin apo jo?

5 Pë. Bashkë. Po.

6 Py. Ku shkuat me të në Mramor në çfarë zone?

7 Pë. Vazhduam në Mramor edhe shoku im i ndjerë e ka njoftë atë  
8 terren shumë ma shumë se ka qenë në një pjesë ku ka qenë  
9 rajoni i tij. Ka qenë i një fshatit, Grashticë. Edhe e ka  
10 njoftë terrenin mirë edhe unë i kam shku mbrapa ma shumë. Tuj  
11 ardhë kena kalu me një pjesë të Mramorit. Prej Mramorit kena  
12 vazhdu një fshat Butovc te një kushëri i tij. Ka qenë mjek me  
13 profesion. Krasniqi mbiemrin, emri s'më kujtohet, domethënë ka  
14 qenë familjar i shokut. Më fal.

15 Py. Në rregull. Qëndruat në atë vend atje në Butovc?

16 Pë. Po kemi qëndru. Kemi qëndru, përafërsisht sa më kujtohet,  
17 dy ditë aty, 36 orë kështu. Përafërsisht.

18 Py. E kuptoj. Në Butovc, a kishte njerëz të cilët ti i njihje  
19 me të cilët u takuat?

20 Pë. Po, po kam pasë. Jam taku me persona të cilët janë  
21 zhvendos nga Prishtina. Shumë jam taku. Edhe ka qenë e ka  
22 vershu q'aq shumë atë pjesë popullata sa që ka qenë diçka e  
23 pamundshme me pa edhe dikënd që ke mujtë me e njofë.

24 Py. Kur keni qenë atje së bashku me Sabit Krasniqin --

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Avokat, unë e kuptova që ai ishte me Sabit Krasniqin në vendin  
2 e parë, që shkoi tek vendi i parë bashkë me të. Ju kërkoj  
3 ndjesë në qoftë se nuk e kuptova mirë unë, por nuk e kam  
4 dëgjuar që ai tha që ai ishte gjatë kohës me Sabit Krasniqin.  
5 A mund t'i abesh këtë pyetje, të lutem?

6 Z. VON BONE: [Përkthim]

7 Py. A erdhi Sabit Krasniqi bashkë me ty dhe a shkuat bashkë  
8 ju në Butovc?

9 Pë. Ne kena qenë bashkë. Rregullisht, kena qenë bashkë me  
10 Sabit Krasniqin për shkak se ai e ka njohë atë terren shumë  
11 mirë.

12 Pë. Në rregull. Dhe më pas ju qëndruat në shtëpinë e të  
13 afërmve të Sabit Krasniqit, kështu?

14 Pë. Po, po.

15 Py. Dhe, pra, ju thatë që kishte shumë njerëz, vendi ishte  
16 plot me njerëz. Po a kishte njerëz të tjerë që ti i njihje nga  
17 më përpara aty?

18 Pë. Po jo konkret, që i kam njofë konkretisht, se më shumë i  
19 ka njohtë Sabiti për shkak ai i q'ati rajoni edhe u njoftë me  
20 ta ma shumë. Unë veç kam nejtë kështu si monitorus.

21 Py. Në rregull. Personat e tjerë nga këshilli i emergjencës  
22 ose nga LDK-ja, a keni takuar ndonjë prej këtyre atje?

23 Pë. Unë personalisht jo. Është taku Sabiti edhe i ka marrë  
24 disa, si me thënë, këshilla të cilat kanë qenë të nevojshme  
25 për atë kohë sidomos ruajtja e dokumentacioneve të cilat i

1 kena pasë me vete, që janë shpërnda ndihma. Domethënë, kanë  
2 qenë disa materiale, materiale për shpërndarjen e ndihmave  
3 edhe ai është marrë Sabiti me atë material. U dashtë me i lënë  
4 diku me i mbyll. Po unë nuk jam marrë me atë punë, u morr ai  
5 domethënë. Unë personalisht jo.

6 Py. Në rregull. A e mbani mend nëse jeni takuar me Salih  
7 Mustafën në Butovc?

8 Pë. Unë personalisht me Salih Mustafën jam taku edhe kena  
9 bisedu, Sabiti edhe unë. Edhe e kena marrë udhëzimet,  
10 këshillat, se në cilin pozicion dhe ku janë aktivistët e  
11 këshillit të emergjencës dhe na ka tregu se ku duhet me shku  
12 për me fillu organizimin të cilin e kena pasë edhe ma herët në  
13 Prishtinë.

14 Kena vazhdu bashkë me Sabitin dhe kena shku në Butovc  
15 prapë, se Butovci e ka një konviveracion, qysh me thanë, shumë  
16 të madh, si me thënë, si ka hapësirë të madhe ka konviveracion  
17 malor, kodrinor-malor.

18 Py. Do t'ju ndërpres në këtë pikë, sepse, së pari, kam një  
19 tjetër pyetje për ju.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Avokat një koment të përgjithshëm. Ju lutem, prisni që  
22 dëshmitari të përfundojë dhe pastaj vazhdoni të bëni pyetjen  
23 tuaj në mënyrë që të sigurohemi që kemi përkthim në  
24 transkript.

25 Z. VON BONE: [Përkthim]

1 Py. Si ndodhi që u takuat me Salih Mustafën atje? Në Butovc e  
2 kam fjalën.

3 Pë. Ndodhi shumë rastësisht. Ndodhi rastësisht, që unë për  
4 momentin aty isha në një pozicion tjetër, por e kuptova që  
5 është Salih Mustafa aty në Butovc edhe shkova se pata direkt  
6 ftesë prej Sabitit, "Hajde se duhet me u ul me bë plane për  
7 sesi me e ndihmu popullatën". Edhe fillova shkova, u takova  
8 dhe i morëm udhëzimet për me shku me u taku me këshillin  
9 tjetër të emergjencës në Butovc, te shpia e Mustafë Sopit. Dhe  
10 ne vazhdum me shku atje.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, më duhet të  
12 bëj një pushim sepse nuk kam gjë në sallë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e  
14 di, a dëshiron që unë të thërras dikë nga seksioni i  
15 teknologjisë dhe informacionit?

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Më duket se duhet të fus dhe  
17 njëherë passwordin, po të shohim.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Mendoj që Sekretari i seancës po thërret për ndihmë.

20 Të lutem, fikenit mikrofonin.

21 Keni nevojë për ndihmë të mëtejshme, Avokat.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo. Është në rregull tani.

23 Py. Më falni. Cili ishte emri që përmendët në fund? Emrin që  
24 nuk e kapa dot? Z. Dëshmitar, përmendët emrin e dikujt më  
25 lejoni ta shoh në transkript.

1 Pë. Emrin e Sabit Krasniqit? Aty ishte fjala?

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mbase po kërkoni informacionin  
3 që jepet në faqen 18, rreshti 22.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Mendoj që ndoshta do të ishte më mirë që ta bënit dhe njëherë  
6 pyetjen. Nuk ja vlen që t'ia jepnim ne emrin.

7 Z. VON BONE: [Përkthim]

8 Py. Z. Dëshmitar, ju thatë ju përmendët Mustafa Sopin. Kush  
9 ishte ky Mustafë Sopi?

10 Pë. Mustafë Sopi ishte një profesor, i cili na ka dhënë mësim  
11 mu edhe Salih Mustafës edhe shumë të tjerëve. Edhe kishte  
12 shtëpinë aty në Butovc.

13 Py. Çfarë ka ndodhë në atë shtëpi?

14 Pë. Në atë shpi jena organizu të gjithë ne, të cilët kena  
15 punu në këshillin e emergjencës. Kena fillu të organizohemi,  
16 të bëjmë plane strategjike për me ndihmu atë popullatë të  
17 zhvendosur në atë pjesë.

18 Py. Atë kujtohet sesa kohë pasi mbërritët atje jeni takuar me  
19 Salih Mustafën?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
21 Avokat, të lutem a e specifikon pak kur flet për mbërritjen  
22 për çfarë e ke?

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Kur ka arritur ose kur ka shkuar  
24 në Butovc për këtë e kam fjalën.

25 Py. A e mbani mend përafërsisht se sa kohë pasi arritët në

1 Butovc, u takuat me Salih Mustafën?

2 Pë. Sa më kujtohet, çka është një shumë një kohë gjatë, sa më  
3 kujtohet dikun ka qenë 28, 29 mars dikun këtu për afërsisht.

4 Prej 27 -- saktë nuk muj ta identifikoj saktë datën edhe orën.

5 Por them diku 27, 28, 29 këtu për afërsisht.

6 Py. E kuptoj.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua t'i kërkoj Trupit Gjykses që  
8 të shfaqet në ekran deklarata e z. Jakup Ismaili.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Avokat, pse dëshiron që të shfaqim në ekran deklaratën? Mënyra  
11 normale është që informacionin ta marrim nga dëshmitari në  
12 gjykatë dhe në qoftë se na duhet një deklaratë e mëparshme për  
13 të rifreskuar memorien, mund të bëjmë këtë gjë. Thjesht do  
14 thosha që bëji pyetjen që donit t'i bënit dëshmitarit.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund t'ja bëj pyetjen, e nderuar  
16 Gjykatëse, po shikoj që ka një mospërputhje ndërmjet tekstit  
17 në anglisht dhe deklaratës së dëshmitarit dhe atë çfarë tha  
18 dëshmitari tani. Dhe për këtë arsye dua që të bëj një sqarim.  
19 Nuk e di në qoftë se është momenti i përshtatshëm ky për ta  
20 bërë këtë gjë?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
22 Dëshmitar, të lutem a i heq dot dëgjueset dhe do t'i kërkoj  
23 Sekretares që të nxjerrë nga salla sepse dua të diskutoj  
24 diçka.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit, znj. Sekretare.

3 Avokat, për çfarë teme dëshironi t'i bëni pyetje  
4 dëshmitarit, tani që nuk e kemi dëshmitarin në sallë. Sepse  
5 juve po kërkoni që të shfaqni një dokument. I kërkua Zyrës së  
6 Administrimit Gjyqësor dhe si dje, duket sikur nuk ka ndonjë  
7 lidhje me atë çfarë po diskutoni.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë mendoj, e nderuar Gjykatëse,  
9 në faqen 4 ka një tjetër datë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe mendoj që është një gabim i  
12 dukshëm edhe thjesht doja që të sigurohesha që bëhet fjalë  
13 thjesht për një gabim në dokument apo jo, apo është gabim i  
14 dëshmitarit. Doja thjesht ta sqaroja.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,  
16 por a nuk është e mundur që t'i bësh ca pyetje të tjera lidhur  
17 me sa i sigurt ai është lidhur me datat që ka përmendur dhe  
18 sigurisht, domethënë mund të shkosh në deklaratën e tij të më  
19 përparshme pas kësaj.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund ta bëj këtë, por mendoj që  
21 ishte koha e përshtatshme që ta bënim këtë gjë tani, përderisa  
22 po flisnim për këtë datë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
24 kuptoj argumentimin tuaj, por mund të insistoni pak më tepër.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirë do ta bëj këtë që thatë ju,



1 më përpara por dua t'ju them të gjithëve, t'i njoftoj të  
2 gjithë, që mund ta pyes dëshmitarin në qoftë se kjo është e  
3 saktë apo jo dhe mund ta konfrontojmë dhe me deklaratën për të  
4 parë se çfarë është e saktë edhe jo.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
6 kuptoj argumentin tuaj. Por si koment i përgjithshëm, a  
7 mundesh, të lutem, që të prezantosh për Trupin Gjykes se pse  
8 dëshiron që të shfaqet një deklaratë e mëparshme lidhur me atë  
9 çfarë po flisni, në mënyrë të tillë që ta bësh të qartë për  
10 neve dhe në mënyrë që të mos të ndërpresë sepse kur nuk është  
11 e nevojshme të ndërpres nuk dua ndërpresë dhe nuk dua që t'ju  
12 ndërpresë herë pas here gjatë marrjes në pyetje të  
13 dëshmitarit.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. E kuptova.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
16 Sekretare, mund ta ktheni sërish dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
19 se u kthyet, z. Ismaili.

20 Z. Avokat, ju lutem vazhdoni.

21 Z. VON BONE: [Përkthim]

22 Py. Z. Dëshmitar, ne folëm që ju u larguat nga Prishtina dhe  
23 mbërritën në Butovc. Dua t'ju pyes dhe njëherë tjetër, kur  
24 keni shkuar, kur keni mbërritur në Butovc më konkretisht?

25 Pë. Ne kemi mbërri në Butovc dikun për afërsisht, dikun 26

1 mars, dikun për afërsisht. S'më kujtohet saktë.

2 Py. Në rregull.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Është ky momenti i përshtatshëm  
4 për ta pyetur dëshmitarin?

5 Py. Z. Dëshmitar, dëshiroj t'ju tregojë një dokument që është  
6 hartuar nga Mbrojtja në kohën kur keni dhënë dëshminë për në.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Ky është dokumenti me numrin e  
8 identifikimit ERN -- ja ta shoh pak se çfarë numri ka.

9 Pra, numri ERN është DSM00187-196. Pra, DSM00187-196. Nga  
10 00187 deri tek 00196. Nuk e di në qoftë se mund të shfaqni dhe  
11 versionin në shqip, ju lutem, që është dokumenti me numër  
12 DSM00688-069.

13 Dhe nga ky dokument dua që shfaqni në ekran faqen 4.  
14 Fundin e faqes 4, më saktë.

15 Py. Z. Dëshmitar, këto janë dokumentet. Dokumenti në të majtë  
16 është në versionin në gjuhën shqipe dhe dokumenti në të  
17 djathtë është në gjuhën angleze. Dëshiroj t'ju kërkoj --

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua t'i kërkoj Sekretarit të  
19 seancës që të shfaqë pyetjen e parafundit në këtë faqe. Është  
20 dokumenti i cili, domethënë, është pjesa, paragrafi që fillon  
21 me "A keni" për këtë paragraf po flas. Dhe dua t'i kërkoj  
22 Sekretarit të theksojë fjalinë e fundit të këtij paragrafi. Po  
23 kjo është fjalia. Mendoj që kjo është fjalia e fundit e këtij  
24 paragrafi.

25 Py. Z. Dëshmitar, ky është përkthimi në shqip të dokumentit

1 në versionin anglisht. Dhe, siç mund ta shihni, fjalia e  
2 fundit është e dhënë dhe e shënjuar. Nuk e di e lexoni dot  
3 këtë fjali, ju lutem?

4 Pë. Po. Po.

5 Py. Po a mund ta --

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

7 Avokat, nuk është e nevojshme. Mjafton t'i thoni, sepse ne të  
8 gjithë e shohim se cila është deklarata. Mund të lexoni dhe ju  
9 vetë me zë dhe pastaj ta pyesni sesi ka mundësi që ka një  
10 dallim midis kësaj që ka thënë në sallë dhe asaj që jua ka  
11 thënë juve, pra, që është 1 prilli, që ua ka thënë datën 1  
12 prill të 2021. Pyeteni.

13 Z. VON BONE: [Përkthim]

14 Py. E shihni që data këtu e shkruar është "mëngjesi i 27  
15 prillit", në qoftë se më kujtohet mirë pas mesnate të 26  
16 prillit. Kjo është shkruar këtu. Pyetja që kam unë është. A  
17 është e vërtetë --

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

19 avokat.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Thjesht për procesverbalin, kjo  
21 pjesë përputhet me atë që ka thënë dëshmitari sot në gjykim  
22 nuk besoj se ka nevojë t'ja përsërisim këtë pjesë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e  
24 kuptoj.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kjo pjesë e deklaratës së

1 dëshmitarit pak a shumë është në përputhje me atë që ka  
2 deklaruar sot në sallë dëshmitari.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka  
4 një problem me datën. Me datën. Mendoj se mund t'ia bëni  
5 pyetjen. Por t'i jepni dhe kontekstin. Sepse tani po  
6 diskutojmë për një datë. Por duhet shpjeguar e gjithë fjalia  
7 se me çfarë ka të bëjë kjo datë.

8 Z. VON BONE: [Përkthim]

9 Py. Z. Dëshmitar, data e mbërritjes suaj, është data që është  
10 shkruar këtu?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
12 mbërritja ku? Z. Avokat, duhet të jetë e qartë. Duhet ta themi  
13 shkoqur çdo fjalë.

14 Z. VON BONE: [Përkthim]

15 Py. Data e mbërritjes tuaj në Butovc a është kjo data që  
16 është shkruar këtu apo është ajo që sapo thatë këtu në sallë?

17 Pë. I nderuari avokat, këtu kjo datë është gjatë përkthimit  
18 nëse ka ndodhë ndonjë gabim. Unë kam dhënë vërejtjen edhe  
19 deklaratën kur e kam lexu këtu edhe s'ka të bëjë me 27 prill,  
20 po me 27 mars. Mu kjo gjatë përkthimit ka mujtë të bëhet  
21 lëshim ose gabim momental. Se shifet që edhe në deklaratë tani  
22 ma tutje del marsi, jo prilli.

23 Py. Ju kuptoj. Pra, për të qenë të qartë për këtë, ju  
24 kujtohet kur na e keni dhënë intervistën, se cilën datë na e  
25 keni thënë aso kohe?

1 Pë. Intervista që është dhënë vetëm për marsin, për 24  
2 marsin. Nuk a dhënë intervistë për 27 prillit këtu. Është bë  
3 gabim teknik. Këtë nuk e pranoj këtë datë 27 prillit për  
4 momentin.

5 Py. Në rregull. Faleminderit shumë. Shumë mirë mund t'i heqim  
6 këto dokumente nga ekрани.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Faleminderit, z. Sekretar.

9 Z. VON BONE: [Përkthim]

10 Py. Pra, sigurisht, mbërritja juaj ka qenë 26 deri në 27  
11 mars. Pyetja që kam është kjo: Sa kohë pa mbërritjes suaj në  
12 Butovc, në këto dy data, sa kohë pas kësaj mbërritjeje e keni  
13 takuar Salih Mustafën, nëse ju kujtohet?

14 Pë. Unë e thashë edhe ma herët, domethënë, datat e sakta  
15 është problem mbas 23 viteve, por gjithmonë e kam orientu  
16 dikun në mars 28, 27, 8, 9, këto domethënë, për afërsisht  
17 domethënë, tri-katër ditë tash. Saktë nuk muj me identifiku.  
18 S'kam shanc, për shkak se është kohë shumë e gjatë edhe kam  
19 problem me kujtesën.

20 Py. Takimi me Salih Mustafën u zhvillua në shtëpinë që  
21 përmendët, pra, në shtëpinë e Mustafë Sopit apo diku gjetkë?

22 Pë. Takimi i parë ka ndodhë në Butovc, jo te shpia e Mustafë  
23 Sopit, ka ndodhë te familjari i Sabit Krasniqit ka qenë mjek.  
24 Unë personalisht, aty nuk kam pasë kontakt direkt personal. Po  
25 udhëzimet, informatën e udhëzimet për më shku te këshilli i

1 emergjencës dhe ku janë të vendosur personat e këshillit të  
2 emergjencës te Mustafë Sopi në Butovc janë marrë nga Salih  
3 Mustafa. Unë direkt nuk kam pasë kontakt në atë moment, por ai  
4 ka qenë aty.

5 Py. Ju kuptova. Në ndonjë moment tjetër, a ndodhi që patët më  
6 shumë kontakt me Salih Mustafën pas këtij takimi të parë?

7 Pë. Pas këtij takimi domethënë kanë qenë takime tjera. Mandej  
8 kur jena shku, jena stabilizu te shtëpia e Mustafë Sopit, kena  
9 fillu me bë organizimin për ndihma humanitare dhe kena fillu  
10 me vepru konkretisht për ndihma humanitare për popullatën e  
11 zhvendosur. E mandej aty ka ardhë te Mustafë Sopi edhe unë nuk  
12 kam qenë aty prezent. Unë kam qenë me një pikë ku është dashtë  
13 të jem i pozicionum për shkak se forcat serbe ishin shumë afër  
14 dhe ish një pikë shumë strategjike dhe është dashtë të jem aty  
15 për me përcjellë situatën se kishim frikë se në momente të  
16 caktume do të ketë ndonjë ofensivë.

17 Py. Ju kuptoj. Pra, ju vetë nuk ndodheshit në shtëpinë e  
18 Mustafa Sopit por në një pikë strategjike. Çfarë ishte kjo  
19 pikë strategjike më me saktësi?

20 Pë. Kjo pikë strategjike ishte një rrugë, e cila kohë mbas  
21 kohe e frekuentojshin forcat serbe. Dhe ishte një rrugë shumë  
22 e ngushtë, rrugë jo e kalushme edhe mora nga Mustafë Sopi  
23 udhëzimin që të jem aty për shkak të mundësisë së veprimit të  
24 forcave serbe dhe njoftimit me kohë të personave të cilat  
25 ishin në pozicion ma poshtë. Mbasandej në atë pozicion, kur ka

1 ardhë Salih Mustafa te Mustafë Sopi e ka njoftu Mustafë Sopin  
2 -- Mustafë Sopi e ka njoftu Salih Mustafën edhe i ka tregu se  
3 personi në fjalë është këtu, këtu, këtu në këtë pikë. Ka qenë  
4 kureshtar për shkak të aktivitetit tim humanitar dhe planeve  
5 të cilat kanë ekzistuar te unë sesi me u furnizim me ushqim, me  
6 barna të plagosurit, të pastrehurit edhe ka qenë kureshtar me  
7 ardhë me pasë direkt kontakt. Siç e thashë ma herët, direkt  
8 kontakt nuk ka pasë me mu, ka pasë me Sabit Krasniqin, direkt  
9 me mu jo ma herët te familjari i tij. Por ka qenë kureshtar të  
10 vjen edhe të ketë kontakte direkt me mu edhe të jetë  
11 projektues i një plani strategjik sesi me vepru dhe si me e  
12 furnizim popullatën civile në atë pjesë. Edhe Salih Mustafa ka  
13 ardhë në pikën të cilën unë kam qendru. Aty e kena vazhdu --  
14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
15 shoh që është ngritur z. Prokuror, në këmbë.

16 Keni fjalën.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
18 Gjykatëse. Mbase Avokati i Mbrojtjes mund të sqarojë se cili  
19 është takimi fillestar, pra, i parë me Salih Mustafën. Se  
20 pyetja ishte: Nëse pas këtij takimi të parë është takuar  
21 përsëri me Salih Mustafën? E kuptoj që ka pasur dhe më përpara  
22 një takim me Salih Mustafën, por tani nga dëshmitari, nga  
23 përgjigja e dëshmitarit, duket se kjo ishte hera e parë në  
24 këtë pikë strategjike që është takuar, në fakt, me Salih  
25 Mustafën.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit, z. Prokuror.

3 Z. Avokat me thënë të drejtën edhe unë e kisha këtë  
4 paqartësi. Shpresoj që do sqarohet. Po mund ta bëni pyetjen.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë e kuptova ndryshe. E kuptova  
6 që së pari --

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
8 vend që të bëjmë supozime mund ta bëni pyetjen direkt  
9 dëshmitarit.

10 Z. VON BONE: [Përkthim]

11 Py. Z. Dëshmitar, për të qenë të qartë, takimi i parë që  
12 bëtë, takimi i parë fare, jo që ishit ju vetëm për vetëm, por  
13 që kishte edhe të tjerë, pra, kur e keni njohur apo takuar për  
14 herë të parë aty kur ka ndodhur se nuk doli fort e qartë?

15 Pë. Takimi i parë dhe zyrtar që unë e kam njoftë Salih  
16 Mustafën ka qenë te pika kur unë kam marrë udhëzime nga  
17 Mustafë Sopi për me monitoru situatën e sigurisë në atë pjesë.  
18 Domethënë, kur e thashë ma herët, pjesën e rrugës ku ka qenë  
19 rruga e pikës strategjike për me monitoru situatën e sigurisë.  
20 Zyrtarisht aty jam taku. Takimin që e thashë unë ma herët që  
21 është taku -- u taku Sabit Krasniqi, unë as që e kam njoftë.  
22 Nuk e llogaris që unë kam pasë takim.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po që  
24 ta kuptoj dhe unë tani. Ka ndonjë takim jozyrtar ku e patë,  
25 nuk e njihnit, sepse u po ngulni këmbë në këtë takim zyrtar,



1 po a ka pasur ndonjë takim jozyrtar përpara?

2 DËSHMITARI: Në atë takim që u taku Sabit Krasniqi, unë  
3 nuk e kam njoftë dhe kam ndejt indiferent shumë ma larg. Nuk e  
4 kam njoftë. S'më ka çu peshë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
6 rregull. Faleminderit.

7 Z. VON BONE: [Përkthim]

8 Py. Pra, ishit i pranishëm por nuk patët ndonjë kontakt në  
9 veçanti lidhur me të. Kështu e kuptoj?

10 Pë. Ka qenë një largësi kështu që nuk e kam njoftë.

11 Py. Në rregull. Pastaj ndodhi ajo që ju e quani takimi zyrtar

12 --

13 Pë. Po.

14 Py. -- në vendin ku po qëndronit ju në atë pikë strategjike,  
15 siç e kuptoj unë?

16 Pë. Po.

17 Py. Ju kujtohet a e mbani mend që keni diskutuar për ndonjë  
18 gjë që po bënte ai? Ju tregoj me se merrej? Ç'aktivitete po  
19 kryente?

20 Pë. Salih Mustafa në atë takim ku ne kena qëndru, ne kena  
21 pasë biseda vetëm për plane strategjike si me vepru dhe si me  
22 hy në Prishtinë me furnizu popullatën civile me armatim, barna  
23 dhe furnizime të tjera. Ka fillu, kena marrë, në kushtet e  
24 asaj kohe, kena marrë një laps që e kishte me vete dhe një  
25 fletore edhe ka kërku nga unë se ku qëndrojnë ma së shumti

1 depot e barnave për shkak se kish nevojë popullata për barna  
2 shumë edhe gjëra tjera të ushqimit, domethënë, depot e  
3 ushqimit. Po sidomos ka qenë i orientum te ku janë depot e  
4 barnave në Prishtinë. Dhe kena fillu me ba biseda sesi me i  
5 tërhjek pi asaj pjese. Çfarë, cila rrugë do të jetë më e  
6 mujshme për më mujt me i tërhjek prej Prishtinës. Dhe këtu  
7 biseda ka qenë. Nuk kanë qenë këto biseda domethënë një orë  
8 dy. Kanë qenë këto biseda, muj me thënë lirisht, pesë-gjashtë  
9 orë, shtatë orë derisa jemi lodhë. Dhe kena fillu dhe së  
10 bashku me dalë, me bë një monitorim të terrenit për shkak të  
11 sigurisë mandej jena kthy të njëjtin vend. Është bë pak ftoftë  
12 edhe ka qenë koha kështu relativisht ftohtë -- ne nuk e kena  
13 ditë që ka aty varre, varre të vjetra, të cilat janë shumë të  
14 vjetra edhe jo të mirëmbajtura edhe jena shtri aty jena ul me  
15 pushu. Realisht ka kërku në torbën time seç ka kam në torbë.  
16 Kam nxjerrë torbën kena pa dhe kena shiqu që ka barna. Barna  
17 për qetësim kam pasë me vete për shkak -- barna të ndryshme  
18 midis tyre barnave --

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.  
20 Ju përgjigjët pyetjes. Z. Dëshmitar, përpiquni që t'i jepni  
21 përgjigje pyetjes që ju bëhet dhe të mos shtjelloni, shpjegoni  
22 shumë. Mjafton të jepni përgjigje pyetjes. Nëse ne kemi nevojë  
23 për sqarime apo mendojmë se kemi nevojë për më shumë  
24 informacione, do t'jua bëjmë pyetjen dhe pastaj ju mund të  
25 shtoni informacione. Faleminderit.

1 Z. VON BONE: [Përkthim]

2 Py. Siç e thatë, po diskutonit sesi barnat t'i nxirrnit nga

3 Prishtina. Po këto barna, medikamente, ku do të shkonin?

4 Ç' destinacion kishin dhe ku do të ruheshin, mbaheshin?

5 Pë. Po mbas planit strategjik që e kena ba së bashku, ato

6 barna kanë qenë të parapame të vendosen në Butovc. Edhe ka

7 kërku që duhet të sigurohen, se muj me ardhë tërë ajo sasi e

8 barnave, po duhet me pasë -- të jenë të sigura dikun me një

9 vend ma të përshtatshëm edhe ka kërku që me i bë disa depo për

10 ruajtjen e barnave dhe faktikisht i kena ba ato depo në tokë

11 në --

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Mjafton. E dhatë përgjigjen. Do të vazhdojmë.

14 Z. VON BONE: [Përkthim]

15 Py. Çfarë lloj depush, magazinimi? Ç'lloj vendi të

16 përshtatshëm bëtë?

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam

18 përshtypjen që dëshmitari nuk e kuptoi pyetjen.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po përpiqesha dhe unë ta lexoja

20 këtu.

21 Py. Çfarë lloj hapësire magazinimi do të ishte kjo? Ku

22 domethënë do vendoseshin?

23 Pë. Do ishte në pyll, në një pjesë ku do të jetë, domethënë,

24 të padukshme se ku janë vendosë. Për shkak, rastësisht forcave

25 serbe po të kalojshin ose po të ishin pjesë e atij rajoni

1 bile, të mos vërehen se ku janë.

2 Py. Ju kuptojmë. Kur thoni që "ne e ndërtuam" për kë e keni  
3 fjalën në shumës "ne e ndërtuam"?

4 Pë. Po nuk e ndërtum vetëm e Salih Mustafa. E ndërtum të  
5 gjithë ne, ata të cilët ishin prezent domethënë. E kam fjalën  
6 shumës se këtu s'e kena bë me individë, po e kena bë me një  
7 numër të madh të aktivistave të këshillit të emergjencës  
8 domethënë.

9 Py. Për të qenë i qartë edhe Sali Mustafa edhe ju vetë  
10 ndihmuat dhe të tjerët që të ndihmojnë --

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
12 Avokat, unë këtu e lexoj që viktima tha se nuk isha unë dhe  
13 Salih Mustafa që e ndërtuam. Ai i ka dhënë përgjigje kësaj  
14 pyetjeje e tha.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Desha që të sigurohem nëse është  
16 ky rasti apo jo. Nëse ka qenë vërtetë kështu. Sepse unë e  
17 kuptoj ndryshe dhe dua që të sigurohem nëse ka marrë pjesë  
18 edhe ai në ndërtimin e këtyre prandaj edhe bëra pyetjen.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
20 Avokat, ajo që unë dua të shmang është që të mos përsëritni  
21 pyetjet sepse nuk është e nevojshme. Por nëse mendoni vërtetë  
22 --

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë thjesht dua të gjej të  
24 vërtetën.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

1 lutem, kur flas unë prisni, jo për mua edhe pse do të ishte  
2 shenjë respekti, sigurisht, por për hir të gjithë të  
3 pranishmëve që janë këtu, sepse nuk bëjmë dot diskutim siç  
4 duhet nëse më ndërprisni, për arsye dhe se përkthehet.

5 Nëse vërtetë mendoni se është e nevojshme përsëriteni  
6 pyetjen, po shpresoj që të më kuptoni se ç' dua të them.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, një moment.

8 [Avokati i Mbrojtjes këshillohet]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
10 Avokat, po afrohem i orës 11.00, mbaheni parasysht që të flasim  
11 shkurt.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Është faqja 32, rreshti 23, për  
13 punën e përkthimit se mendoj se duhet bërë edhe një herë  
14 pyetja sepse nuk është hedhur siç duhet në tekstin në  
15 anglisht. Për këtë arsye.

16 Py. Z. Dëshmitar, ju dhe z. Salih Mustafa, pra, ju vetë dhe  
17 z. Salih Mustafa a keni marrë pjesë në ndërtimin e këtyre  
18 vendmagazinimeve, vendruajtjeve, pra, a ndihmuat edhe juve?  
19 Pë. Unë kam marrë pjesë, ndërsa Salih Mustafa nuk ka marrë  
20 pjesë.

21 Py. Po ai ku shkoi ose çfarë bëri?

22 Pë. Nuk kam ide. Nuk kam ba pyetje me ditë se ku ka shku.

23 Py. Gjatë periudhës kohore, që po merreshit me ndërtimin e  
24 këtyre bunkerëve, a jeni takuar -- e keni parë rregullisht  
25 Salih Mustafën?

1 Pë. E kam pa duke lëviz me Mustafë Sopin.

2 Py. A e ke parë edhe te bunkerët, tek këto vendruajtjet?

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Një pyetje më e përshtatshme do  
4 të ishte ku e patë dhe jo t'ia bëjë gati përgjigjen  
5 dëshmitarit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Faleminderit z. Prokuror. Z. Avokat, a mund ta bëni pyetjen të  
8 hapur me fund të hapur ju lutem?

9 Z. VON BONE: [Përkthim]

10 Py. Në ç'vend tjetër e keni parë?

11 Pë. Salih Mustafën e kam parë në shtëpinë e Mustafë Sopit.  
12 Dhe kohë mbas kohe në lëvizje në terren. Në pjesën e terrenit  
13 aty ku kena qenë na të vendosur.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka  
15 shkuar thujse ora 11.00.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Mund ta bëjmë ndërprerjen  
17 këtu për seancën.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Faleminderit, z. Avokat.

20 z. Dëshmitar, Asistentja e sallës do t'ju shoqëroj që të  
21 dilni për pushimin tani do të rishihemi pas gjysëm ore.  
22 Faleminderit.

23 [Dëshmitar përfundon dëshminë]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
25 Faleminderit, znj. Asistente e sallës.

1 Do të bëjmë pushimin këtu bëhet ndërprerja e seancës.

2 --- Pauza fillon në orën 10.59

3 --- Seanca rifillon në orën 11.30

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
5 se u rikthyet. Shoh që përbërja e ekipeve është e njëjtë, po,  
6 për procesverbalin. Shumë mirë.

7 Ka diçka të cilën dëshiroj ta sqaroj me Mbrojtjen.

8 Z. Avokat, a mund t'i sqaroni Trupit Gjykes se cila ka  
9 qenë procedura e marrjes së deklaratës nga ana e ekipit të  
10 Mbrojtjes sepse shohim që ka një version në anglisht të  
11 nënshkruar nga dëshmitarët, pra, në çdo faqe e kanë sigluar  
12 dhe pastaj shohim që ka përkthim në shqip. Mirëpo ndërkohë  
13 dëshmitarët janë shqipfolës. A mund të na e shpjegoni që ta  
14 kuptojmë më mirë këtë gjë?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Po nuk është bërë nënshkrimi i  
16 përkthimit në shqip nga asnjë dëshmitar. Teksti në anglisht ka  
17 qenë teksti bazë. Më kujtohet se kanë qenë ditë të gjata. Mund  
18 të kenë zgjatur dhe 12 orë ndonjëherë. Kështu është vepruar.  
19 Kemi regjistruar çdo gjë që ka thënë dëshmitari.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
21 anglisht?

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Pastaj përkthehej nga z. Pelaj. E  
23 kontrollonim përsëri. Dhe kështu kemi vepruar. Siç e shihni ka  
24 një gabim të qartë por kjo është ajo që ka ndodhur --

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e

1 kam fjalën për këtë që doli këtu sot. Por që ta kuptoj qartë,  
2 ta përmbledh dhe më korrigjoni nëse nuk e kam kuptuar mirë.

3 Dëshmitari ka folur në shqip, çfarë ka thënë dëshmitari  
4 është përkthyer në anglisht. Kjo është shkruar, kjo deklaratë  
5 pastaj është kontrolluar edhe njëherë bashkë me dëshmitarin  
6 dhe nëse pajtoheshit nënshkruhej dhe pastaj, këtu vjen një  
7 interpretim im në këtë rast, më pas kjo deklaratë e  
8 dëshmitarit që ishte në anglisht është përkthyer, të themi,  
9 përsëri në shqip me shkrim.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Po që të kishit një version në  
11 shqip.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Prandaj dhe është shkruar aty përkthimi në shqip.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Faleminderit.

17 Atëherë do ta sjellim dëshmitarin në sallë dhe do të  
18 vazhdojë me pyetjet Avokati i Mbrojtjes dhe do të më informoni  
19 -- do t'ju informojmë më saktë sesa minuta keni shfrytëzuar  
20 për pyetjet.

21 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërohëni dëshmitarin  
22 të hyjë në sallë.

23 [Dëshmitar vijon dëshminë]

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
25 Faleminderit, znj. Asistente e sallës.



1 Mirë se jeni rikthyer z. Ismaili.

2 DËSHMITARI: Mirë se ju gjetëm.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
4 vazhdojmë tani me pyetjet që do të vazhdojë t'jua bëjë Avokati  
5 i Mbrojtjes.

6 z. Avokat, jeni fjalën.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
8 Gjykatëse.

9 Py. Z. Dëshmitar, na e treguat tashmë se kur është bërë  
10 takimi i parë fillestar, takimi në të cilin ju ishit i  
11 pranishëm por nuk patët kontakt me z. Mustafa. Na e treguat  
12 tashmë se kur ka ndodhur kjo. Pyetja që kam është kjo; Hera  
13 tjetër që jeni takuat me të sa ditë kishin kaluar nga hera e  
14 parë ku ishit thjesht një person i pranishëm?

15 Pë. Sa mu më kujtohet, kjo qenë dikun në fillim deri në  
16 fillim të prillit. Atë që e kam thanë pak ma herët, domethënë,  
17 ka qenë fillimi i prillit 7, 8 fillimi i prillit. Që prej  
18 takimit që unë, e ka qenë takim formal, që unë s'kam marrë  
19 pjesë, në takimin e dytë ka shku shtatë-tetë ditë. Domethënë  
20 planet për me hi në Prishtinë, planet operative me si me  
21 tërhjek barnat, ka qenë dikun përafërsisht mbas 7-8 ditëve.  
22 Dikun fillimi i prillit 7-8, përafërsisht. Fillimi i prillit.

23 Py. Përmendët, cekët që po bënit plane, ju lutem, mund të na  
24 thoni nëse edhe z. Mustafa merrte pjesë në këto takime në të  
25 cilat po bëheshin planet?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

2 Avokat, më duket se në faqen 30, thuhet që pikërisht me Salih

3 Mustafa në atë takim ne dikutuam për plane strategjike sesi të

4 vepronim, si të hynim në Prishtinë, si të furnizonim civilët.

5 E tha që ishte i pranishëm.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Po kjo ishte një pyetje paraprake

7 për një gjë tjetër.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ashtu

9 por, po bëni një pyetje që është bërë tashmë.

10 Z. VON BONE: [Përkthim]

11 Py. Kush tjetër ka marrë pjesë në këto takime për përgatitjen

12 e planeve?

13 Pë. Në atë moment, për këto plane, kena qenë vetëm unë e

14 Salih Mustafa. Vetëm unë e Salih Mustafa. Për shkak se në

15 shtëpinë time ka pasë furnizime me barna, për shkak se motra,

16 baba, të gjithë më kanë punu në fakultetin e mjekësisë dhe për

17 shkak të situatës dramatike, situatë që ka qenë kohë lufte, ne

18 jena mundu me u furnizu në shtëpi. Dhe në shtëpinë time ka

19 pasë edhe të zhvendosur nga rajone të tjera edhe është dashtë

20 të jetë furnizimi me barna. Edhe e kam njoftu se çfarë sasive

21 të barnave ka në shtëpi.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

23 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni pyetjes mos jepni shpjegime të

24 tjera. Se nuk ishte kjo pyetje. Pyetja ishte: A ishte dikush

25 tjetër i pranishëm apo jo? Mjafton të thoni kaq.

1 DËSHMITARI: Jo.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse  
3 ne pastaj duam të dimë më shumë, mund t'ju bëjmë pyetje. Është  
4 e qartë kjo?

5 E kam parë Prokurorin.

6 Po nuk e di a është e qartë për dëshmitarin, sepse jua  
7 thashë edhe më përpara z. Dëshmitar, ju lutem, përgjigjuni  
8 vetëm pyetjes dhe mos jepni shpjegime të tjera jashtë pyetjes.

9 Po, z. Prokuror, keni fjalën.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse edhe unë  
11 dua të them, që t'i themi ta citojmë procesverbalin siç duhet  
12 sepse Avokati i Mbrojtjes tha "kush tjetër ka marrë pjesë në  
13 këto takime për të bërë plane?". Me sa më kujtohet dëshmitari  
14 ka përmendur vetëm një rast, një takim ku janë diskutuar këto  
15 gjëra. Nuk ishte më shumë sesa një takim në të cilat  
16 dëshmitari ka diskutuar plane me Salih Mustafën, të paktën  
17 sipas asaj që ka thënë këtu sot.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit, z. Prokuror.

20 Kështu është apo jo z. Avokat?

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. E nderuar Gjykatëse.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
23 rregull atëherë. Për hir të procesverbalit e mbajtmë shënim u  
24 tha.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, ka pasur një.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
2 lidhje me këtë temë?

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

4 Py. Ju ose - më falni - a janë diskutuar plane që keni bërë  
5 ju apo z. Mustafë Sopi?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
7 Avokat, me kë? Me kë? Kur?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Po për këtë është pyetja.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
10 jo, jo.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Pyetja e parë është: A janë  
12 diskutuar dhe plane të tjera me ju ose z. Mustafë Sopi? Dhe  
13 pastaj pyetja tjetër është kur dhe ku?

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mua  
15 nuk më duket që është e qartë. Unë dua që të kuptoj se çfarë  
16 pyetje po bëni.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] A kishte dhe plane të tjera.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
19 kjo është shumë e përgjithshme.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk është e përgjithshme.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
22 lutem, më lini të flas unë një herë. Kjo është shumë e  
23 përgjithshme, sipas mendimit tim dhe ju kërkohet që ta  
24 perifrazoni dhe ta thoni ndryshe për ta bërë më konkrete.

25 Z. VON BONE: [Përkthim]

1 Py. z. Dëshmitar, gjatë periudhës kohore në të cilën ju  
2 ndodheshit aty, në Butovc apo në vendndodhjen tuaj, a janë  
3 bërë plane të tjera gjatë asaj periudhe kohore nga ju ose nga  
4 z. Mustafë Sopi?

5 Pë. Jo.

6 Py. Po takime të tjera? Jo. Do ta them ndryshe, më falni.  
7 Gjatë periudhës kohore për të cilën po flasim, pra, që prej  
8 mbërritjes suaj aty deri në takimin me Salih Mustafën e kam  
9 fjalën për takimin ku ju ishit thjesht i pranishëm, gjatë  
10 kësaj periudhe kohore, aktivistë të tjerë të cilët ndodheshin  
11 në Butovc, a bënë plane, pra, a pati plane të tjera që janë  
12 bërë nga aktivistë të tjerë të cilët ndodheshin në Butovc?

13 Pë. Plane konkrete për me hy unë vetëm si individ në  
14 Prishtinë me i tërhjek ato medikamente kanë qenë direkt  
15 nëpërmes meje dhe Salih Mustafës. Është ma vonë për -- është  
16 shtri edhe te Mustafë Sopi edhe te tjerët. Ma vonë.

17 Py. Folëm më herët për atë që mund ta quajmë takimin tuaj të  
18 parë me Salih Mustafën zyrtar, takimin tuaj të parë zyrtar me  
19 Salih Mustafën - më falni - takimin zyrtar me Salih Mustafën.  
20 Nga ky moment edhe sa kohë për afërsisht qëndroi Salih Mustafa  
21 në Butovc? Edhe sa ditë të tjera e keni parë?

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
23 Avokat, mos vallë duhet ta pyesni njëherë nëse e ka parë apo  
24 jo pas atij takimi? Sepse ju po nënkuptoni sikur ai e ka parë.

25 Z. VON BONE: [Përkthim]

- 1 Py. Pas takimit tuaj të parë me Salih Mustafën, takimit  
2 zyrtar, a e patë edhe më pas Salih Mustafën?
- 3 Pë. Po.
- 4 Py. Edhe afërsisht edhe sa ditë të tjera apo edhe sa herë të  
5 tjera e patë Salih Mustafën aty?
- 6 Pë. Shtatë-tetë ditë mundet me qenë përafërsisht.  
7 Përafërsisht. Herën e dytë.
- 8 Py. A ju kujtohet nëse në një moment ai është larguar prej  
9 atij vendi mbase është përshëndetur me ty apo mbase të ka  
10 thënë se do të shkonte diku në vend tjetër?
- 11 Pë. Nuk më kujtohet. Vetëm më kujtohet kur ka pasë dikun të  
12 plagosur, e di që i kanë lëviz. Ka lëviz ku janë të  
13 plagosurit. Ma tepër s'di. Nuk më kujtohet. Me pa e kam pa që  
14 ka qenë dy-tri herë aty që ka lëviz.
- 15 Py. Kur thoni "aty" aty për ku e keni fjalën?
- 16 Pë. E kam fjalën te shtëpia e Mustafë Sopit.
- 17 Pë. Ju kuptoj. A dini gjë se ku i duhej që të shkonte në  
18 ç'krahinë, në ç'vend apo do shkonte në qytet? Ku do shkonte?  
19 Dini gjë për këtë?
- 20 Pë. Kjo bisedë mu nuk më kujtohet. Mu personalisht nuk më  
21 kujtohet.
- 22 Py. Në ato raste që jeni takuar me Salih Mustafën. Çfarë  
23 kishte të veshur ai? Çfarë lloj teshash i kishte veshur ai?
- 24 Pë. Salih Mustafa kishte veshje diçka të veçantë. Kishte një  
25 jelek të gjuetisë. Civil, ma shumë civil. Përveç jelekut të

1 gjuetisë ish civil komplet.

2 Py. Kishte shenjë apo embleme në atë jelek apo në teshat që  
3 kishte veshur, ndonjë embleme të caktuar?

4 Pë. Unë personalisht nuk e kam pa.

5 Py. A di nëse kishte armë me vete?

6 Pë. Po.

7 Py. Çfarë lloj arme kishte?

8 Pë. Nuk më kujtohet. Një lloj skorpion. Nuk më kujtohet. S'i  
9 njoh armët.

10 Py. Gjatë asaj periudhe kohore për të cilën po flasim, në  
11 Butovc, ju vetë çfarë lloj teshash kishit veshur?

12 Pë. Unë kam qenë me rroba civile.

13 Py. Ishit i armatosur ju vetë?

14 Pë. Po.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Një moment, të nderuar Gjykatës.

16 [Avokati i Mbrojtjes këshillohet]

17 Z. VON BONE: [Përkthim]

18 Py. Z. Dëshmitar, ju vetë ishit anëtar i UÇK-së?

19 Pë. Po.

20 Py. Çfarë roli, me ç'cilësi ishit anëtarë i UÇK-së?

21 Pë. Ushtar.

22 Py. A bënit pjesë në ndonjë njësi, brigadë apo formacion  
23 tjetër të UÇK-së?

24 Pë. Po.

25 Py. Në cilën?

1 Pë. Njësinë guerile BIA.

2 Py. Çfarë ishte kjo njësi?

3 Pë. Ishte një formacion ushtarak si çdo formacion tjetër.

4 Py. Kush tjetër apo cilët persona të tjerë i njihnit atëherë  
5 si anëtarë të BIA-s?

6 Pë. Unë, personalisht i kam njoftë Mustafë Sopin, Gani Sopin,  
7 Azil Borovcin edhe s'më kujtohen emra tjerë për momentin.

8 Py. Po ju vetë çfarë funksioni luanit brenda BIA-s?

9 Pë. Si ushtar. Asgjë tjetër.

10 Py. Ju vetë a bënit pjesë në ndonjë lloj shoqate veteranësh  
11 të UÇK-së?

12 Pë. Po.

13 Py. Ju lutem, ç'lloj shoqate veteranësh është kjo?

14 Pë. Veteranë.

15 Py. A ka ndonjë dallim midis shoqatave të veteranëve sa u  
16 takon anëtarëve të këtyre shoqatave? Pra, ka ndonjë dallim  
17 midis anëtarëve të shoqatave të veteranëve me sa keni ju  
18 dijeni?

19 Pë. Sa kam dijeni unë janë veteranë luftëtarë, veteranë,  
20 invalidë. Këto i di s'ma tepër.

21 Py. Ju në cilin grup veteranësh bëni pjesë?

22 Pë. Veteranë luftëtarë.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj se i mbaruam pyetjet tona.

24 Faleminderit shumë, z. Dëshmitar.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]



1 Faleminderit, Avokat i Mbrojtjes.

2 Të kuvendoj një çast me Sekretarin.

3 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Seancës

4 këshillohen]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

6 Prokuror, jeni fleksibël nëse nuk përdorni më shumë kohë që na

7 është caktuar për të organizuar ditën. Pyetja ime është kjo:

8 Si ju, si ZPS, preferoni që të bëjmë pushimin tani dhe pastaj

9 të filloni kundrapyetjet më pas apo dëshironi që të vazhdoni

10 tani dhe deri në orën 13.00 siç është orari normal.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne me

12 kënaqësi do ta bënim një pushim tani.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të

14 pyes njëherë nëse është e mundshme.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, ju faleminderit.

16 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Seancës

17 këshillohen]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh

19 që avokati i Mbrojtjes është ngritur në këmbë.

20 Z. Avokat, keni fjalën.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] A mund t'i bëj një pyetje të

22 fundit dëshmitarit?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Patjetër, z. Avokat. Mund t'ia bëni.

25 Keni fjalën.

1 Z. VON BONE: [Përkthim]

2 Py. Z. Dëshmitar, pyetja ime është kjo? Ju vetë a keni marrë  
3 pjesë në luftime gjatë periudhës së luftës?

4 Pë. Po.

5 Py. Në cilën zonë, ku?

6 Pë. Në pikërisht në Gollak. Pikërisht në Butovc.

7 Py. Mirë. Faleminderit shumë. Nuk kam më pyetje.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit, z. Avokat i Mbrojtjes.

10 Atëherë do të veprojmë kështu. Do të bëjmë pushim deri në  
11 orën 13.30. Dhe do të vijojmë kështu sot mbas dreke duke  
12 rikuperuar orët që nuk i bëmë tani, se vetëm gjysëm orë kemi  
13 bërë. Pastaj do të shohim edhe dokumentin e fundit që na ka  
14 ardhur. Dhe në orën 13.30 do të filloj kundrapyetjet nga ZPS-  
15 ja, pas të cilës do të vijmë kundrapyetjet mbas Mbrojtjes së  
16 Viktimave.

17 z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pauzë deri në orën  
18 13.30, pastaj do të vazhdojmë. E qartë? Në rregull.

19 Ju uroj pushim të këndshëm.

20 Znj. Asistente e sallës ju lutem shoqërojeni dëshmitarin  
21 të dalë nga salla.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

24 mirë. Në rregull. Faleminderit. Do të rifillojmë në orën

25 13.30.

1 --- Pauza e drekës fillon në orën 11.57

2 --- Seanca rifillon në orën 13:29

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh  
4 që janë të njëjtët persona të pranishmit tani siç ishin gjatë  
5 seancës së parë, kështu që mund të vazhdojmë më tej.

6 Z. Sekretare, a mund ta shoqëroni dëshmitarin brenda  
7 sallë.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
10 lutem hiqeni maskën, z. Dëshmitar.

11 Mirë se u kthyet, z. Dëshmitar.

12 DËSHMITARI: Faleminderit.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Patët  
14 një pushim të mirë?

15 DËSHMITARI: Po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
17 ka ardhur radha që Zyra e Prokurorisë së Specializuar të  
18 vijojë më tej me pyetjet e tyre. Tani do t'ja jap fjalën  
19 Prokurorisë. Z. Prokuror, e keni ju fjalën.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
21 Gjykatëse.

22 Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis:  
23 Py. Mirëdita, Z. Ismaili. Sa për fillim, do të doja që të  
24 sqaroja me ndihmën tuaj, kohën e lëvizjeve dhe takimeve me  
25 Salih Mustafën, siç dolën nga dëshmia juaj sot paradite.

1 Ju jeni larguar nga Prishtina në orët e para të datës 24  
2 mars, menjëherë pasi kishin filluar bombardimet. Është kështu?

3 Pë. Po.

4 Py. Ju keni shpenzuar thujtë 24 orë në Hajvali, në një  
5 qytezë të vogël. Ju kërkohet ndjesë në qoftë se nuk e thashë siç  
6 duhet, nuk e shqiptova siç duhet. A është e saktë kjo?

7 Pra, z. Dëshmitar, dua që ta thoni edhe me fjalë, dhe jo  
8 vetëm thjeshtë të tundni kokën, sepse dua që të pasqyrohet në  
9 procesverbal.

10 Pë. E saktë.

11 Py. Më pas, pas Hajvalisë, juve vazhduat më tej në Mramor dhe  
12 prej Mramorit në Butovc, ku keni arritur përafërsisht me datë  
13 26 mars, të vitit 1999, sipas dëshmisë që dhatë sot paradite.  
14 Kështu është?

15 Pë. Po, kështu është.

16 Py. Ju i thatë Trupit Gjykes sot paradite që herën e parë,  
17 kur e keni takuar Salih Mustafën, ishte në një takim jo  
18 zyrtar, dhe takimi ka ndodhur ose me 28 ose me 29 mars, të  
19 vitit 1999 ose rreth kësaj date, në shtëpinë e kushëririt të  
20 Sabit Krasniqit. A është e saktë kjo?

21 Pë. E saktë.

22 Py. Por atëherë nuk fole me të, pra ju të dy nuk u prezantuat  
23 me njëri tjetrin herën e parë.

24 Pë. Po, nuk jemi prezantuar.

25 Py. Faleminderit. Tani dua të kaloj te ajo çka ju përshkruat

1 si takimi i parë zyrtar, domethënë kur ti dhe Salih Mustafa  
2 folët me njëri tjetrin. Unë e kuptova që kjo ka ndodhur në një  
3 pikë strategjike, ku ju ishit roje. A është e saktë kjo?

4 Pë. E saktë.

5 Py. Kjo është e parë, hera e parë që u prezantuat me Salih  
6 Mustafën.

7 Pë. Saktë.

8 Py. Dhe kjo prapë sipas dëshmisë që dhatë sot paradite, ka  
9 ndodhur ose me 7 ose me 8 prill, ose 7-8 ditë pas takimit të  
10 parë. Kështu ishte?

11 Pë. Po.

12 Py. Dhe ti nuk ke bërë më ndonjë takim tjetër me Salih  
13 Mustafën nga kjo herë - në këto dy rastet, domethënë. Është e  
14 saktë kjo?

15 Pë. Po, edhe një takim, dhe po sa hyra këtu deshta me marrë  
16 leje nga Gjyqtarja. Kam pasur problem me kujtesën dhe jam  
17 takuar prapë dhe kam e kam harruar. Dhe kur kam dalë m'u ka  
18 kujtu.

19 Py. Në rregull. Dhe kur ka ndodhur ky takimi, në çfarë kohe,  
20 në këtë herën që e harrove t'ja thoshe Trupit Gjykues?

21 Pë. Në të njëjtin muaj, diku me 20 prill. Përafërsisht, s'më  
22 kujtohet saktë data. Ne kena udhëtuar deri në Prishtinë dhe  
23 kena tentu me hy me tërheqë medikamentet. Por prej  
24 pamundësisë, jena kthy mbrapsht, kena blerë disa gjëra te një  
25 person i komunitetit rom, disa gjëra ushqimore dhe jena kthy

1 mbrapsht. Kjo ka zgjat tetë orë. Kërkoj ndjesë Avokatit, që  
2 mua në moment nuk m'u ka kujtu, për shkak se kam problem me  
3 kujtesën.

4 Py. Pra, ju sapo na thatë që kjo mund të ketë ndodhur me  
5 datën 20 prill. Pra ka qenë pas herës kur jeni takuar me të në  
6 këtë pikën strategjike. Kështu?

7 Pë. Saktë.

8 Py. Dhe do të ishte thujse 12-13 ditë pas kësaj here, sipas  
9 afatit kohor që na shpjeguat. Është kështu?

10 Pë. Kështu është.

11 Py. Shumë mirë.

12 Pra kemi një takim të shkurtër, kur ti e ke parë atë, më  
13 datë 27 ose 28 mars, herën e parë. Pastaj kemi herën e dytë me  
14 datë 7 apo 8 prill, ose 7-8 ditë pas takimit të parë. E saktë?

15 Dhe ishte edhe kjo hera, kur ju shkuat për të kërkuar  
16 barna, medikamente në Prishtinë ose përreth Prishtinës më datë  
17 20 prill. E saktë?

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

19 Prokuror, ju lutem bëjini mjaftueshëm pushimet, në mënyrë të  
20 tillë që të mund të mos mbivendosen përkthyesit, që të  
21 mbarojnë të gjithë frazën.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, faleminderit. Do ta kem  
23 parasysh.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] A mund të sqaroj diçka, ju lutem?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,

1 patjetër. E keni ju fjalën.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] E kam thjesht për avokatin e  
3 Prokurorisë. Domethënë, herën e dytë është ose në datë 7 ose 8  
4 prill ose 7-8 ditë pas takimit të parë. Kështu thatë apo jo?

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, kështu.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
7 qoftë se e mbaj mend mirë, dëshmitari i dha këto dy deklarime  
8 në dy momente të ndryshme, jo njëra pas tjetrës.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, por bëhet fjalë për të  
10 njëjtën datë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e  
12 kuptoj argumentin tuaj. Të lutem thoni argumentin që keni.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Pra, marsi ka 31 ditë dhe takimi  
14 i parë, në qoftë se ka ndodhur me datë 28, i takon që do të  
15 jetë më herët se 7 apo 8 ditë pas takimit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë  
17 do të thuash me këtë?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Po them që në transkriptim  
19 thuhet: "7 ose 8 prill. 7 ose 8 ditë pas takimit të parë".  
20 Thjesht dua që të them -

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka të  
22 fikur telefonin. [sipas përkthimit]

23 Herës tjetër në qoftë se futemi kaq shumë në detaje.  
24 Është e rëndësishme që të mos ndikojmë mbi dëshmitarin.

25 Pra faleminderit që e ngritët këtë çështje, znj. Avokate

1 e Viktimave.

2 Znj. sekretare, ju lutem, a mund ta nxirrni dëshmitarin  
3 nga salla?

4 Z. Ismaili, do t'ju nxjerrin nga salla.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
7 Sekretare, faleminderit.

8 Pra, do t'i japim kohën për të folur si Prokurorit ashtu  
9 edhe Mbrojtjes. Besoj që Mbrojtja e Viktimave ngriti çështjen  
10 e kësaj.

11 Për t'ju drejtuar juve, dua të them që unë e dëgjova  
12 dëshmitarin që i ka thënë të dyja gjërat sot paradite. Dhe me  
13 këtë gjë e përballi Prokurori dëshmitarin.

14 z. Prokuror, dëshironi që të bëni një koment tjetër?

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ajo çfarë thatë juve është  
16 tërësisht e saktë. Thjesht e kujtova dëshmitarin në atë çfarë  
17 tha sot paradite. Pra nuk ishte i sigurt në qoftë se takimi i  
18 dytë kishte ndodhur me datë 7 apo prill, apo 7 apo 8 ditë pas  
19 takimit të parë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
21 kuptoj që në qoftë se bëjmë një përllogaritje, ashtu siç tha  
22 edhe Prokurori, siç e bëri Prokurori, pra që janë 13-14 ditë  
23 më pas.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Shtatë ditë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]



1 Domethënë, në qoftë se do të bëjmë numërimin nga 7 ose 8  
2 prilli dhe në qoftë se bëjmë numërimin e 7 apo 8 ditëve,  
3 domethënë nga 26-27 marsi, mund të jetë disa ditë më përpara.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Ky ishte argumenti im. Pra  
5 thjeshtë për t'u siguruar që thjesht të mos ngatërrojmë ndonjë  
6 gjë.

7 Pra në qoftë se është 7-8 ditë pas 28 marsit, nuk të del  
8 llogaria që të jetë 7 apo 8 prilli. Për këtë arsye reagoja dhe  
9 kërkova fjalën.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
11 por transkriptimi ka reflektuar tërësisht atë çfarë ka thënë  
12 dëshmitari, kështu që sugjerimi im për herën tjetër është që,  
13 në varësi të asaj që mund të marrësh si ditë nisjeje, prej  
14 kësaj date duhet bërë llogaritja.

15 Dhe në këtë mënyrë juve na kujtoni të gjithë ne se cili  
16 është argumenti juaj. Pra dëshmitari me ç'duket e kupton  
17 anglishten, kështu që në qoftë se do që të nxjerrësh prova  
18 prej ti, është e rëndësishme që ne të sigurohemi që ai të dalë  
19 nga salla përpara se ne të bëjmë komentet tona, në mënyrë që  
20 të mos e ndikojmë atë në lidhje me çfarë do të thotë.

21 Z. Prokuror, ka ndonjë gjë tjetër që doni të shtoni apo  
22 të kërkoj që të sillet në sallë dëshmitari?

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, thjesht po qëndroj në këmbë  
24 për t'i bërë pyetjen e radhës dëshmitarit.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

1 Sekretare, ku lutem shoqërojeni dëshmitarin në brenda.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
4 se erdhe, z. Ismaili. Do të vazhdojmë me pyetjet nga  
5 Prokuroria.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
7 Gjykatëse.

8 Py. Gjatë dëshmisë që dhatë sot paradite, ju nuk i keni thënë  
9 Trupit Gjykues rreth këtij takimi që na e përmendët pak më  
10 përpara, por i thatë Trupit Gjykues që e keni takuar Salih  
11 Mustafën një herë pas takimit në pikën strategjike. Dhe ju  
12 thatë që ky takim ka ndodhur 7 deri në 8 ditë pas takimi në  
13 pikën strategjike.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kjo mund të lexohet në faqen 48  
15 të transkriptimit, të nderuar Gjykatës.

16 Py. Në qoftë se unë të ta përmbledhja, do t'ju pyesja, a e  
17 kujtoni që e keni thënë këtë gjë, z. Ismaili, që kjo ka  
18 ndodhur në shtëpinë e Mustafë Sopit?

19 Pë. Sa më kujtohet, se është shumë kohë e gjatë, dhe e kam  
20 problem shumë me kujtesën, po sa mu kujtohet mua, aty në pikën  
21 strategjike jemi takuar. Dhe aty në shumicë njerëzish, 20-30  
22 vetë, sa kanë qëndruar aty. Unë nuk e llogaris takëm. Ajo  
23 është në distancë.

24 Py. Në rregull. Pas takimit te pika strategjike, nga ky  
25 moment dhe deri në kohën kur keni shkuar në Prishtinë sa

1 bashku, që i thatë Trupit Gjykues që ka ndodhur rreth datës 20  
2 prill, a ka pasur ndonjë takim tjetër që keni bërë me Salih  
3 Mustafën në Butovc?

4 Pë. Nuk ka pasur.

5 Py. Ju deklaruat se në një pikë keni ndërtuar bunker, në  
6 mënyrë që të ruanit, të magazinonit medikamentet. A është e  
7 saktë kjo?

8 Pë. E saktë.

9 Py. Dhe se Salih Mustafa nuk ka marrë pjesë me juve në  
10 ndërtimin e këtyre depove, bunkerëve, apo jo?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua  
12 që të ndalojmë këtu për një moment. Ju kërkoj ndjesë përsëri,  
13 z. Dëshmitar, por do t'ju nxjerrim sërish nga salla. Do ju  
14 shoqërojë sekretarja, sepse na duhet të diskutojmë diçka  
15 lidhur me deklaratën tuja.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
18 Faleminderit.

19 Sot në mëngjes ne diskutuam një moment se kush ndërtoi  
20 bunkerët, depot për furnizimet dhe u thatë që mund të ketë  
21 pasur një problem me përkthimin. Kolegu juaj e tha këtë gjë.

22 Unë i kërkoja shërbimeve të përkthimit që ta kalonin edhe  
23 një herë këtë pasazh për t'u siguruar se çfarë ishte thënë  
24 sepse mendova që është shumë e rëndësishme që të bëjmë  
25 konstatime, pra që të shohim se çfarë është thënë në të

1 vërtetë apo jo dhe për këtë arsye ju ndërpreva. Pra, përpara  
2 se të kalojmë te kjo çështje, dua që ta sqaroj këtë gjë, dhe  
3 me ç' duket, fjalia duhet të lexohet si më poshtë:

4 "Nuk ishim vetëm unë dhe Salih Mustafa që e ndërtuam  
5 këtë, nuk e ndërtuam vetëm ne të dy..."

6 Kjo u tha.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, por pastaj në faqen 34,  
8 rreshti 12, mendoj që përgjigja e parë që sapo ju lexuat, e  
9 nderuar Gjykatëse, ishte e paqartë. Pra, mund të interpretohet  
10 ose në një mënyrë ose në tjetrën, por pastaj më vonë ai thotë  
11 në rreshtin 12 në faqen 34, në transkriptimin në kohë reale.  
12 Pyetja ishte:

13 "A morët pjesë ju dhe Salih Mustafa në ndërtimin e kësaj  
14 depoje?"

15 E përgjigja ishte:

16 "Unë po, por Salih Mustafa nuk ishte pjesë e ndërtimit.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta  
18 lë pjesën tjetër të pyetjeve. Do jua lë juve. Ndoshta do të  
19 ketë edhe pyetje të tjera nga pala Mbrojtës më vonë, por  
20 thjeshtë doja të sqaroja që pjesa e parë duhet të lexohet në  
21 këtë mënyrë dhe kur të kthehet dëshmitari, do t'ja them edhe  
22 atij.

23 Kështu duam që të vijojmë me këtë. Atëherë dua ta them  
24 edhe një herë që fjalia duhet të lexohet si e tillë, pra  
25 fjalia nuk ishte përkthyer mirë në fillim, dhe prandaj nuk

1 është reflektuar siç duhet në transkriptim. "Nuk isha vetëm  
2 unë dhe Salih Mustafa që e ndërtoam atë".

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ndoshta mund ta sqarojmë këtë  
4 gjë duke e pyetur përsëri dëshmitarin, sepse në fjalinë tjetër  
5 thotë tjetër gjë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
7 Prokuror, vazhdoni si ta shikoni të arsyeshme, por kjo ishte  
8 thjesht sa për procesverbal.

9 Shumë mirë.

10 Keni ndonjë gjë tjetër për të thënë, z. Avokat?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, vetëm thjesht doja të  
12 sigurohesha që do të informohej dëshmitari.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
14 do ta informojmë dëshmitarin.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, a synoni  
16 që ta informoni dëshmitarin për përgjigjen përpara se t'ja bëj  
17 pyetjen unë apo t'i bëj unë njëherë pyetjen dhe pastaj të  
18 shohim se çfarë përgjigje do japë dëshmitari?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
20 Avokati i Mbrojtjes, çfarë mendoni?

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Besoj që është e drejtë që t'i  
22 themi dëshmitarit që përgjigja juaj nuk është reflektuar siç  
23 duhet në transkriptim dhe të thuhet që si duhet të ishte  
24 shkruar përgjigja e tij. Dhe pastaj në një moment tjetër  
25 kolegu mund ta pyesë, që duket se nuk është në të njëjtën

1 linjë me atë çfarë tha më përpara dhe mund të vijojmë kështu.

2 Pra, unë mendoj që siç u tha edhe më parë, duhet që si  
3 fillim t'i themi dëshmitarit atë çfarë ka thënë.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk jam dakord, sepse ky është  
5 përkthim në anglisht. Përkthimin e kemi marrë neve.  
6 Përkthimin nuk e ka marrë dëshmitari, kështu sqarimi është për  
7 neve, nuk është për të. Ai e di çfarë përgjigje ka dhënë,  
8 kështu që mendoj që do ta ngatërronim pak më tepër dëshmitarin  
9 në qoftë se do t'ja thoshim. Dhe në vend të kësaj mund t'i  
10 bëjmë pyetjen përsëri.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
12 Von Bone, fjala për ju.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e mendoj kështu. Në fakt ajo  
14 është ajo çfarë ka thënë dëshmitari dhe në qoftë se kjo është  
15 diçka që ka thënë dëshmitari, atëherë atë ka thënë dëshmitari.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë  
17 keni për t'i thënë si përgjigje Prokurorit.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Kam të njëjtin qëndrim. Pra duhet  
19 t'i themi së pari dëshmitarit që ti ke thënë këtë gjë. Ta  
20 sqarojmë këtë dhe pastaj diku tjetër mund të themi që diku  
21 tjetër ke thënë diçka tjetër dhe pastaj mund të bëjmë pyetje  
22 për të gjetur se cila është e vërteta.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
24 Atëherë si do të vijojmë është kjo: së pari dua që të bëhet  
25 pyetja, dhe pastaj do t'i themi -- në qoftë se ka problem,

1 domethënë, do t'i themi të dyja versione të cilat unë sapo ua  
2 lexova.

3 Pra, shprehjen tjetër që përdori dhe çfarë ka thënë më  
4 përpara. Mendoj që kjo është mënyra se si mund të marrim  
5 informacionin më objektiv nga dëshmitari.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara  
7 Gjykatëse.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
9 sekretare, ju lutem a mund ta sillni brenda në sallë  
10 dëshmitarin.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
13 Dëshmitar, do të vazhdojmë.

14 z. Prokuror, e keni u fjalën.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

16 Py. Z. Dëshmitar, kjo depoja e ruajtjes, a e ka ndërtuar  
17 Salih Mustafa bashkë me ty atë?

18 Pë. Nuk e ka ndërtuar Salih Mustafa bashkë me mua.

19 Py. Faleminderit, z. Dëshmitar.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani do të  
21 kaloj në një tjetër temë të pyetjeve të mia, sepse sa i takon  
22 kohës së takimeve së dëshmitarit, është mjaftueshmërisht e  
23 qartë me aq sa mund ta vlerësoja unë.

24 Shikoj që Avokati i Mbrojtjes është në këmbë.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj që më duhet të vazhdojmë,

1 siç u tha. Unë nuk dua të futem në detaje, por kjo ishte vetëm  
2 thjesht një pyetje, dhe nuk mendoj që ramë dakord kështu në  
3 lidhje me këtë temë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Sugjerimi im është që ju mund të bëni pyetje plotësuese dhe  
6 pastaj kur të vijë radha, mund të bëni pyetje plotësuese, nëse  
7 keni.

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

9 Py. Z. Dëshmitar, ju sot i thatë Trupit Gjykes që herën e  
10 parë kur jeni takuar me Salih Mustafën, pra kur jeni  
11 prezantuar me të, ka qenë në prill të vitit 1999 në këtë pikën  
12 strategjike. E saktë, domethënë jeni takuar diku në prill të  
13 vitit 1999 me të? E saktë?

14 Pë. Fillimin e prillit, sa më kujtohet.

15 Py. Siç e thatë disa herë sot, që nuk i mbani mend mirë  
16 gjërat tani, apo jo?

17 Pë. E saktë, kam probleme me kujtesën.

18 Py. A keni mbajtur kontakt me z. Mustafa pas luftës?

19 Pë. Po.

20 Py. A është shok, mik i juaji Salih Mustafa?

21 Pë. Është.

22 Py. Ai është mik?

23 Pë. Mik.

24 Py. A keni kontakte të vazhdueshme ju me të, gjatë viteve të  
25 fundit, a keni pasur kontakte me të?



1 Pë. Po, kemi pasur kontakte.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a mund të  
3 kërkoj që të shfaqet në ekran dokumenti SPOE003255 deri në  
4 SPOE00325606, faqja e parë e këtij dokumenti, ju lutem.

5 Py. Z. Ismaili, -- z. Sekretar, nuk e di në qoftë se mund ta  
6 zmadhoni pak, siç ishte më përpara fleta dhe një çikë më  
7 tepër.

8 Z. Ismaili, a e shihni numrin tuaj të telefonit në ekran,  
9 ai që ka emrin tuaj poshtë?

10 Pë. Po.

11 Py. Nëse do ju kisha thënë që nga data 24 korrik 2019 deri me  
12 darë 22 shtator 2020, që ju keni shkëmbyer 138 mesazhe me  
13 Salih Mustafën, a mund të jetë e mundur kjo?

14 Pë. Po, mund të jetë e mundur.

15 Py. Dhe nëse do të të thosha që për afërsisht në të njëjtën  
16 kohë keni bërë 193 telefonata midis njëri-tjetrit dhe që  
17 asnjëra prej tyre nuk ka marrë përgjigje, a të duket kjo diçka  
18 që mund të ketë ndodhur?

19 Pë. Edhe një herë, s'e kuptova, të lutem. Ma bëj edhe një  
20 herë, s'e kuptova mirë.

21 Py. Ju kërkoj ndjesë, do e përsëris edhe në herë. Po thosha  
22 që për afërsisht në të njëjtën periudhë, pra nga 24 korriku i  
23 vitit 2019 deri më 23 shtator i vitit 2022 janë regjistruar  
24 193 biseda telefonike të zhvilluara midis juve të dyve. A ju  
25 duket e mundur kjo gjë?

1 Pë. Po, e mundur është.

2 Py. Dhe nëse do të thosha që në javën nga 15 deri në 23  
3 shtator të vitit 2020, deri dy ditë përpara arrestimit të z.  
4 Mustafaj ka pasur 27 telefonata?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
6 Prokuror, me të drejtë kolegu im thotë që me 23 shtator 2022.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të nderuar  
8 Gjykatës, se doja të thosha 23 shtator të vitit 2022, jo të  
9 vitit 2022.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur  
11 të mbaroni me këtë pjesë të pyetjes, ju lutem një sekondë, na  
12 thoni në mënyrë që të themi edhe ne diçka. Domethënë kur të  
13 mbarosh me këtë pjesë të pyetjeve, na thuaj.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

15 Py. Pra, në javën 23 shtator 2020 janë bërë 27 thirrje  
16 telefonike, midis telefonit tuaj dhe telefonit të Salih  
17 Mustafës. A ju duket një numër i mundur ky?

18 Pë. Po.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë  
20 aspekt dua që të kërkoj regjistrimin në provë një ekstrat  
21 raporti të telefonatave, të thirrjeve telefonike, ndërmjet z.  
22 Salih Mustafa dhe Jakup Ismailit, që do të jetë dokumenti  
23 SPOE00325590-00325606 [sipas përkthimit]. Kjo që kemi në ekran  
24 tani është regjistri i mesazheve të shkëmbyera midis  
25 dëshmitarit dhe të akuzuarit. Por unë meqenëse bëra pyetjet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Jakup Ismaili (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 67

1 për telefonatat, kemi edhe regjistrimin e telefonatave që  
2 mbështet numrin për të cilin i bëra pyetje dëshmitarit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
4 z. sekretar, më thoni.

5 [Trupi Gjykes dhe Sekretari i Gjykatës  
6 këshillohen]

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do  
8 t'i caktohet një numër sa më shpejtë, pastaj do t'ju themi.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në rregull.

10 Të nderuar Gjykatës, unë do ta mbaroj këtë temë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E  
12 mendova përsëri atë që diskutuam më përpara sa i takon pyetjes  
13 të cilën ja bëtë dëshmitarit, sa i takon ndërtimit. E  
14 rimendova atë që thashë më përpara. Besoj se duhet vepruar  
15 ashtu siç ramë dakord. Ramë dakord që ju t'i bënit pyetjen,  
16 pastaj t'i thoshit se çfarë kishte thënë më përpara, sepse  
17 kështu ramë dakord me të dyja palët. Unë e di që normalisht  
18 ZPS-ja i bën kundrapyetjet ashtu siç dëshiron t'i bëjë, por  
19 ramë dakord për këtë pyetje që do të vepronim në këtë mënyrë.  
20 E kuptoj edhe argumentin e Avokatit të Mbrojtjes.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk e di nëse doni që ta lexoj  
22 përkthimin siç është thënë në transkriptin sot dhe përgjigja  
23 që dha dëshmitari?

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
25 Përkthimi i ri -- është e komplikuar për ta thënë këtë gjë,

1 pra, se -- por përkthimi që kemi marrë nga Njësia e  
2 Përkthimit.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo se nuk dua ta bëj, por nuk  
4 më kujtohet, kam frikë se nuk më kujtohet fjalë për fjalë  
5 përkthimi i ri.

6 Unë mendoj që përkthimi i parë, përgjigja ishte ambigue,  
7 domethënë e paqartë, mirëpo dy herë e ka thënë dëshmitari sot  
8 në procesverbal që nuk ishte kështu në fakt.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
10 kuptoj, pra po thoni se nuk jeni i sigurt se mund t'ja bëni me  
11 saktësi pyetjen dëshmitarit?

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, e nderuara Gjykatëse, kam  
13 frikë se mos e them gabim, e citoj gabim përkthimin që kam  
14 përpara.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
16 Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën. Nuk duam të ngatërrojmë  
17 askënd.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Kemi transkriptin, mund të  
19 lexohet nga transkripti ajo që ju thatë është përkthimi  
20 saktë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Mendoj se është e drejtë kjo që thotë Avokati i Mbrojtjes.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk ka asgjë këtu të paqartë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një  
25 moment, nuk do të diskutojmë asgjë në prani të dëshmitarit.

1           Z. VON BONE: [Përkthim] Unë shpresoj shumë që ZPS-ja të  
2 mos bëjë të njëjtën gjë, që të shfrytëzojë rastin dhe të thotë  
3 është kështu, apo ashtu, duke përdorur rezerva në lidhje me  
4 këtë.

5           Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë nuk e di, e nderuar  
6 Gjykatëse, me të thënë të drejtën, sugjeroj që më mirë këtë ta  
7 bëjë Avokati i Mbrojtjes me cilësinë e vet, ose do ta bëjë  
8 vetë.

9           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Atëherë po e bëj unë vetë. Në pyetjet plotësuese të Avokatit  
11 të Mbrojtjes, mund t'i ktheheni sërish kësaj teme.

12           Z. Ismaili, sot paradite, kur po diskutonim se kush i  
13 ndërtoi këta bunkerë, ju sapo i thatë Prokurorit se -- ta  
14 shikoj edhe një herë, sepse dua ta them me saktësi atë që  
15 thatë ju - nuk e di nëse mund të më thotë dikush në ç'rresht  
16 ka qenë. Jo, është faqja 34. Po, kenë thënë kështu, z.  
17 Dëshmitar. Pyetja ishte:

18           "Z. Dëshmitar, ti dhe z. Salih Mustafa, a morët pjesë në  
19 ndërtimin e këtyre vend ruajtjeve, a ndihmuat ju?"

20           Dhe ju thatë:

21           "Unë mora pjesë, Salih Mustafa nuk mori pjesë". Kështu  
22 është?

23           DËSHMITARI: Po, saktë.

24           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me zë  
25 më të lartë.

1 Sot paradite, të njëjtën pyetje jua bënë dhe u  
2 përgjigjët:

3 "Jo vetëm unë dhe Salih Mustafa i kemi ndërtuar".

4 Dhe dua që të di, të më shpjegoni, çfarë deshët me thënë  
5 me këtë. Pra "nuk isha vetëm unë dhe Salih Mustafa që i  
6 ndërtuam" se mbase nuk është e njëjtë me këtë që thatë tani.  
7 Thjeshtë dua që të sqarohem, të jem e qartë.

8 DËSHMITARI: Dallimin, e nderuara Gjykatëse, është te puna  
9 fizike. Me hartimin e planit të bunkerëve ka marrë pjesë edhe  
10 Salih Mustafa. Në aspektin fizik, domethënë në aspektin e  
11 ndërtimit fizik, këtu është dallimi. Domethënë unë e kam  
12 kuptuar në atë kuptimin e planit operativ për me i ndërtu. A,  
13 jo në aspektin fizik me punu punë fizike, aty. Se edhe ashtu,  
14 ka qenë me shëndet shumë i dobët. S'ka pas shans me përdor  
15 mjete të punës. Këtu është dallimi, këtu ka qenë ajo që s'jena  
16 kuptu mirë mes veti. Te puna fizike, nuk ka marrë pjesë. Te  
17 hartimi edhe planifikimi për me i ndërtu dhe me i vendos  
18 medikamentet, kena marrë pjesë unë edhe Salih Mustafa edhe  
19 është zbatu edhe te të tjerët. Kanë marrë tani pjesë të  
20 gjithë, për me ndërtu, me i hap, por në aspektin fizik, s'ka  
21 marrë pjesë. Këtu është dallimi.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit, z. Dëshmitar.

24 Z. Prokurori, mund të vazhdoni.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara

1 Gjykatëse. Faleminderit për sqarimin.

2 Py. Z. Ismaili, keni shkëmbyer thirrje telefonike me Salih  
3 Mustafën pas arrestimit të tij, që ndodhi me 25 shtator 2020?

4 Pë. Po.

5 Py. Sa shpesh i keni kryer këto telefonata?

6 Pë. S'më kujtohet saktë, por e di që ka ndodhur çdo javë.

7 Py. Pra, çdo javë keni folur. Ndërkohë që bëheshin këto  
8 biseda, a u familjarizuat ju vetë me çështjen gjyqësore dhe  
9 provat që do t'i paraqiste për t'u mbrojtur vetë ai?

10 Jo, do ta përsëris, se nuk isha i qartë.

11 A i diskutuat akuzat që ngriheshin kundër atij dhe si po  
12 ecte gjyqi kundër tij?

13 Pë. Unë i kam -- kam krijuar pakënaqësi, si me thënë. Unë  
14 vetë personalisht kam qenë i kyçur dhe kam bërë pyetje, "çka a  
15 bo?". Tanë jeta ka shkuar në aspektin humanitar dhe në  
16 aspektin human edhe me ardh me u ngrit aktakuzë. Unë i kam  
17 folur haptazi pakënaqësitë.

18 Py. Ju kuptoj, faleminderit, z. Dëshmitar.

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk kam më pyetje të tjera për  
20 këtë dëshmitar, të nderuar Gjykatës. Kaq pyetje kishim.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit, z. Prokuror.

23 Tani rendin e ka Mbrojtja e Viktimave. Keni fjalën.

24 Dëshironi të bëni ndonjë pyetje?

25 Znj. VOSENBERG: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës,

1 shumë shkurt.

2 Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave:

3 Py. Mirëdita, z. Dëshmitar. Sot më herët dhe për referencë e  
4 kam fjalën për faqen 44, rreshtin 14 të transkriptimit sot, na  
5 thatë se ishit pjesë e BIA-s. Kështu?

6 Pë. Po, e saktë.

7 Py. A mund të na thoni se kur jeni kyçur në BIA?

8 Pë. Në qershor, të vitit 1998. Sa më kujtohet.

9 Py. Si ndodhi që ju bashkuat, domethënë që u kyçët në BIA,  
10 domethënë a ju rekrutuan? Si ndodhi?

11 Pë. Unë kam pasur një shok dhe mik timin, Sabit Krasniqin  
12 edhe kena formuar një këshill, dhe ai këshilli u marr me  
13 çështje humanitare, çështje e ndihmave, dhe kështu ka vajtur.

14 Znj. VOSENBERG: [Përkthim] Kërkoj një çast për t'u  
15 këshilluar.

16 [Avokatët e Viktimave këshillohen]

17 Znj. VOSENBERG: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
18 Gjykatës, faleminderit, z. Dëshmitar. Kam edhe një pyetje  
19 tjetër.

20 Py. A e dinit se kush ka qenë komandanti i BIA-s?

21 Pë. Unë deri mbas luftës nuk e kam kuptu, s'e di. Deri mbas  
22 luftës, s'e kam marrë vesh, s'e kam ditur.

23 Py. Faleminderit, këto ishin pyetjet e mia.

24 Znj. VOSENBERG: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar  
25 Gjykatës.



1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit, Mbrojtëse e Viktimave.

3 Avokati i Mbrojtjes, dëshironi që të vijoni me pyetjet  
4 plotësuese për dëshmitarin?

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuara, Gjykatëse, një  
6 moment sa të diskutojmë për diçka.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Patjetër, mund të vazhdoni.

9 [Avokatët e Specializuar këshillohen]

10 [Trupi Gjygues dhe Sekretarja i Gjykatës

11 këshillohen]

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

13 të shoqëroni ju lutem dëshmitarin të dalë nga salla?

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Zgjati diçka më shumë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë

17 mendova se ju do të këshilloheshit me bashkëmbrojtësin, por ju  
18 thjesht u ngritët në këmbë dhe u larguat.

19 Herën tjetër dëshiroj që të na tregoni njëherë neve që do  
20 të flisnit me klientin dhe pastaj nëse kërkon më shumë kohë do  
21 të shikojmë. Kështu që herën tjetër, kur dëshironi të flisni  
22 me z. Mustafa, na merrni leje dhe ne sigurisht do të bëjmë  
23 gjithçka të mundshme që ju të këshilloheni me klientin.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, e nderuara  
25 Gjykatëse, thjesht vura re se klienti dëshironte të bisedonte

1 me mua. Por, megjithatë, është e qartë.

2 A është e mundur me atë rast, që të marrim pesë minuta  
3 pushim, pakë a shumë për t'u këshilluar me klientin sepse dua  
4 që të sigurohem që i kemi mbuluar të gjitha.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
6 Atëherë të shoh -- tani është ora -- nuk e si, sa i do, pesë  
7 minuta? Dhjetë minuta?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhjetë minuta. Shoh personin e  
9 sigurisë. Besoj është OK që të dalim të gjithë ne nga salla  
10 dhe ju të qëndroni këtu me z. Mustafa dhe ekipin e Mbrojtjes.

11 Në rregull, atëherë do të rifillojmë pas dhjetë minutash.  
12 Këtu ndërpritet seanca.

13 --- Pauza fillon orën 14:19

14 --- Seanca rifillon në orën 14:29

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Përpara sesa të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit dhe ta  
17 sjellim përsëri në sallë dëshmitarin.

18 Për Prokurorin mund të depozitoni kërkesën për pranimin e  
19 dokumenteve deri më datë 8 prill.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Në rregull.

21 Po përderisa nuk e kemi sjellë listën e dokumenteve vetëm  
22 thjesht do të doja që ta njoftoja Panelin, Trupin Gjykuese që  
23 dokumentin do ta parashtrojmë në mënyrë që të mund të pranohet  
24 në prova.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Znj. Sekretare të lutem a mund ta sjellësh brenda  
3 dëshmitarin?

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirë se u kthyet z. Dëshmitar.

7 DËSHMITARI: Faleminderit.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani  
9 do të vazhdojmë me pyetje plotësuese nga Avokati i Mbrojtjes.  
10 Z. Avokat i Mbrojtjes keni fjalën për pyetje plotësuese.

11 Pyetje vijuese nga z. Von Bone:

12 Py. Z. Dëshmitar, kam disa pyetje të shkurtra.

13 Prokurori tha që ju keni pasur disa thirrje telefonike me  
14 z. Mustafa në kohën që ai po vinte këtu në Holandë.

15 Pyetja ime është kjo: A ka sjellë ndonjë dallim kjo, ka  
16 ndonjë ndikim mbi dëshminë që keni dhënë këtu në dëshmi, pra  
17 ajo çfarë keni bërë në Butovc në periudhën e vitit 1999?

18 Pë. Kurrfarë ndikimi nuk ka pasë. Në aspektin më real, penal,  
19 njerëzor, material, ju njoftoj se kurrëfarë ndikimi nuk ka  
20 pasur. Biseda normale si të zakonshme, sikur gjithmonë i këna  
21 ba. Edhe sa ka qenë në liri edhe mbasi ka qenë - që është i  
22 akuzum tash. Biseda normale.

23 Py. Në rregull. Z. Mustafa a të ka kërkuar ty ndonjë herë që  
24 të thuhet diçka në favor të tij, apo të të kërkojë që të thojë  
25 diçka që do t'i vinte për shtat atij, që do të ishte në dobi

1 të tij kur do jepje dëshminë?

2 Pë. Jo.

3 Py. A të ka thënë thënë ndonjë person tjetër ty, ose a të ka  
4 kërkuar ndonjëherë ndonjë person të dëshmon ndonjë gjë tjetër  
5 të ndryshme nga e vërteta kur të vije të jepje dëshminë tënde  
6 këtu në Gjykatë apo gjatë dhënies së dëshmisë për Mbrojtjen  
7 kur të flisje për periudhën mars/prill 1999?

8 Pë. Nuk e kisha leju veten unë edhe po të kishte tentu  
9 dikush, por për fat të mirë askurrkush s'ka ndiku. Unë vetë  
10 jam lajmëru.

11 Py. Shumë faleminderit.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Faleminderit, Avokati i Mbrojtjes.

15 Z. Prokuror dëshironi që të bëni pyetje të tjera për këtë  
16 dëshmitar?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatës.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit, shumë mirë.

20 Avokatja e Viktimave?

21 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Jo nuk kemi pyetje.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Atëherë nuk keni pyetje të tjera ju.

24 Z. Ismaili gjatë ditës së sotme ju janë bërë shumë pyetje  
25 nga Avokati i Mbrojtjes, nga Prokuroria dhe Avokatja e

1 Viktimave.

2 Tani e ka radhën Trupi Gjykses që t'ju bëjë disa pyetje  
3 të tjera shtesë. Dua të kërkoj durimin tuaj lidhur me këtë.  
4 Shpresojmë dhe mendojmë që këto pyetje të mund të na japin më  
5 shumë qartësi lidhur me temat që kemi cekur sot dhe që keni  
6 deklaruar si pjesë e dëshmisë tuaj deri tani.

7 Më lejoni ti jap fjalën kolegut tim, kolegut në të majtën  
8 time i cili do t'ju bëjë disa pyetje.

9 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit znj.  
10 Kryegjyqtare.

11 Pyetje nga Trupi Gjykses:

12 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Z. Ismaili, në faqen 29 të  
13 transkriptit, rreshti 20 deri 23, ti the se u dërguat që të  
14 monitoronit situatën e sigurisë në rrugë.

15 A mund të na shpjegoni ju lutem se pse ju dërguan ju, pse  
16 të dërguan ty për të monitoruar situatën. Sepse ne e kuptuam  
17 se ju ishit përgjegjës për ndihmën humanitare, kështu që pse  
18 ishit ju personat që u caktuar për monitorimin e kësaj rruge.  
19 Pë. Më vjen keq, por këtu ka qenë një numër shumë i vogël i  
20 ushtarëve edhe nuk ka mujt vetëm një ushtar me qëndru me një  
21 vend. Jena ndërru kohë mas kohe.

22 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, ju jeni marrë, keni bërë  
23 edhe gjëra të tjera përveç ndihmës humanitare?

24 Pë. Edhe obligimet e mija ushtarake.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.

1 Në faqen 31, rreshti 2, thuhet në një pikë që ju po  
2 furnizonit së bashku me Salih Mustafën popullsinë civile në  
3 Prishtinë me armë. Është gabim në transkript ky apo këtë keni  
4 thënë?

5 Pë. Ky është gabim total.

6 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Mirë në rregull. Do i  
7 kthehem sërish kësaj.

8 Në faqen 43, rreshti 1 i transkriptit thatë që z. Mustafa  
9 ishte në lëvizje. A mund të na shpjegoni pak më tepër se çfarë  
10 doni të thoni kur thoni se ishte në lëvizje?

11 Pë. Me një aspekt, të gjithë këna qenë në lëvizje. Nuk kena  
12 qenë me një vend, asht dasht me lëviz se aty ka pasë 12.000  
13 njerëz, popullatë civile. Edhe me një aspekt unë kam lëviz në  
14 Prishtinë. Dikush ka lëviz mas të plagosurve, dikush ka lëviz  
15 mbas të sëmurëve, dikush ka lëviz varësisht prej punëve që i  
16 janë kërku në momente të caktume. S'kena shku atje me qendru  
17 me një vend edhe mos me pa situatën e përgjithshme si po  
18 rrjedh.

19 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra ti vetë në Butovc në  
20 prill 1999 edhe ju vetë ishit në lëvizje domethënë, nuk është  
21 se asnjë nuk ishte në Butovc.

22 Pë. Shumicën e kohës kemi qenë në Butovc. Pika kryesore ka  
23 qenë Butovc. Kena lëviz, Kena lëviz në momente të caktume  
24 sipas detyrave që i kemi pas, po në fund jena kthu prapë në  
25 Butovc. Pika kryesore ka qenë Butovci. Shtëpia e Mustafë

1 Sopit.

2 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Kur thua "kena shku" në  
3 shumës "ne". Kush është ne?

4 Pë. Po flas për vedin, po flas vetëm për vetveten. U ka dasht  
5 me hy në Prishtinë, me dalë me u rikthyer me pa situatën si  
6 është me tërheq barna, me tërheq ushqim. Por në momente të  
7 caktume kur kam qenë i lirë kam dalë në pika të caktume edhe  
8 si ushtar.

9 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit.

10 Në faqen 44, rreshti 14 ti the që ishte pjesë e BIA-s si  
11 ushtar i BIA-s kujt i raportojë?

12 Pë. Unë i kam raportu të ndjerit, shokut tim, Sabit  
13 Krasniqit.

14 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] A e di ti se kujt i  
15 raportonte ai? Kush ishte shefi i tij?

16 Pë. Nuk e di. Nuk e di. Më vjen keq.

17 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Faleminderit. A e njihnit ju  
18 strukturën organizative të BIA-s?

19 Pë. Jo. Jo.

20 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Pra, ti ke qenë ushtar për  
21 një vit në BIA dhe i raportojë vetëm një personi dhe nuk e  
22 dije se si ishte e organizuar BIA?

23 Pë. Vetëm një personit. Ka qenë situata e tillë është dashtë  
24 të jenë shumë ma të kujdesshëm për shkak të sigurisë.

25 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Por mendoj që ti, domethënë

1 punoje bashkë me ushtarë të tjerë në BIA. Domethënë ti nuk i  
2 ndiqje ato nuk i raportoje ato?

3 Pë. Vetëm me këshillin dhe përgjegjës sin Sabit Krasniqi.

4 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Shefi i kujt ishte ky, e mban  
5 mend?

6 Pë. Shef i kujt? Na e kishim një këshill në lagje, në lagjen  
7 tonë e kishim një këshill, edhe aty e kishim një këshill për  
8 LKÇK-në, Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës se sa ishim  
9 të - direkt me njësi guerile ose me aktivitete ushtarake.

10 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Z. Sabit Krasniqi a kishte  
11 ndonjë pozitë konkrete specifike në BIA?

12 Pë. Jo, ai veç ka qenë përgjegjës të një këshilli të lagjes.

13 GJYKATËSI BITTI: [Përkthim] Në rregull. Shumë  
14 faleminderit, z. Ismaili.

15 Nuk kam pyetje të tjera, e nderuar Kryegjyqtare.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA [Përkthim]  
17 Faleminderit Gjykatësi Bitti.

18 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA [Përkthim] Z.  
20 Ismaili kemi përfunduar me dëshminë tuaj. Nuk kemi më pyetje  
21 më për juve nga ana e Trupit gjykses. Dua t'ju falënderoj për  
22 përpjekjet dhe për dëshminë e dhënë e cila besoj që do ta  
23 ndihmojë Trupin Gjykses që të zbulojë të vërteten.

24 Shumë faleminderit ju urojmë rrugë të mbarë për në  
25 shtëpi. Dhe dua t'ju kujtoj që të mos e diskutoni dëshminë e



1 dhënë përpara Dhomave të Specializuara me askënd.

2 Tani do t'i kërkoj znj. Sekretare që t'ju shoqërojë dhe rrugë  
3 të mbarë edhe një herë.

4 DËSHMITARI: Faleminderit nga ana e juaj.

5 [Dëshmitari largohet]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA [Përkthim]

7 Faleminderit znj. Sekretare.

8 Ka disa çështje që duhet të trajtohen përpara se sa ta  
9 mbyllim për sot dhe sigurisht që do t'ju jap fjalën edhe juve  
10 në qoftë se ka diçka që doni ta diskutoni me Trupin Gjykses.

11 Do t'i kërkoja Njësisë së Administrimit Gjyqësor në qoftë  
12 se mund t'i kërkonte Njësisë së Përkthimit dhe Interpretimin  
13 që të shikojnë në faqen 31 rreshti 25 dhe faqen 32, rreshti 1  
14 dhe 2 dhe sepse atje në veçanti tek referenca e dytë përmendet  
15 fjala "armë". Pra medikamente dhe furnizime të tjera dhe  
16 përmendet dhe fjala "armë".

17 Trupi Gjykses do t'i kërkonte Shërbimit Gjyqësor që të  
18 shikonte këtë çështje dhe pastaj të na jepte përgjigje kur të  
19 kenë një përgjigje.

20 SEKRETARI: [Përkthim] Sigurisht do ta koordinojmë këtë  
21 gjë duke dëgjuar duke bërë krahasimin me video dhe  
22 audioregjistrimin dhe atë çfarë është shkruar në transkript.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA [Përkthim]

24 Faleminderit z. Sekretar.

25 Tani do të nxjerr dy urdhra gojorë.

1 Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka nxjerrë sot paradite me  
2 29 mars dokumente shtesë që duhet të përdoren për marrjen në  
3 pyetje të dëshmitarit 500 për nesër. Trupi Gjykues vëren që  
4 ZPS-ja mund të përdorë këto materiale për marrjen në pyetje të  
5 dëshmitarit 500.

6 Pra, janë dokumente të cilat janë marrë të martën datën  
7 29 maj me email në orën 08.56. Trupi Gjykues mendon se ZPS-ja  
8 ka kërkuar leje, i ka kërkuar Trupit Gjykues në pajtim me  
9 paragrafin 31 të Vendimin për Zhvillimin e Gjykimeve.

10 Trupi Gjykues nuk sheh ndonjë arsye për të mos lejuar  
11 këto dokumente që janë dokumentet me burim të hapur kështu që  
12 ne e autorizojmë ZPS-në që të mund të përdorë këto materiale  
13 për seancën e nesër.

14 Ky është fundi i urdhri të parë gojor.

15 Urdhri i dytë gojor është ky.

16 Në pajtim me vendimin e nëntë për mbajtjen në paraburgim  
17 të ZPS-së, u urdhërua dorëzimi i dokumentit, parashtrimi 339  
18 që duhet të ishte bërë në fakt me redaktimet publike dhe kjo  
19 duhet të dorëzohet deri të premtën 1 prill 2002.

20 Dhe ky është fundi i vendimit të Trupit Gjykues dhe  
21 shikoj që Prokuroria pohon.

22 Z. Prokuror a ka ndonjë gjë tjetër që doni të shtroni.

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse, nuk  
24 kemi gjë tjetër.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA [Përkthim]

1 Avokati i Mbrojtjes? Avokati i Viktimave, më falni.

2 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Jo nuk kemi gjë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA [Përkthim]

4 Avokati i Mbrojtjes?

5 Z. VON BONE: Jo asgjë konkretisht, por versionet e  
6 redaktuar publike të cilat kanë të bëjnë me mbajtjen në  
7 paraburgim. U mundam që t'i parashtronim sot por nuk kishim  
8 bashkëpunimin e sistemit, kështu që thjesht doja të konstatoja  
9 që këtë parashtrim do ta bëjmë për pak. Dhe kjo është e gjitha  
10 që doja të thoja për tani.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA [Përkthim]

12 Në rregull. Faleminderit.

13 Do të mblidhemi sërish nesër me datë 30 mars në orën  
14 09.30 me dëshminë e dëshmitarit 500, që është z. Hazir  
15 Boroviçi.

16 Falënderoj palët për pjesëmarrjen etyre, falënderoj  
17 gjithashtu përkthyesit, stenografët, mbështetjen audiovizive,  
18 sigurinë dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë.

19 Seanca ndërpritet këtu.

20 --- Seanca mbyllet në orën 14.49

21

22

23

24

25